



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Nr. _____ prot.

Elbasan, më _____.____.2025

Lënda: Dërgim i analizës vjetore

MINISTRISË SË BRENDSHME

Mbështetur në Ligjin 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, gjeni bashkëngjitur analizën vjetore të Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan për vitin 2024.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Ali MYSLIU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

ANALIZA E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT
VITI 2024

Elbasan më 20.01.2025

Gjatë vitit 2024, veprimtaria e institucionit të prefektit të Qarkut Elbasan ka vijuar në funksion të ushtrimit të përgjegjësi dhe përmbushjes së misionit për zbatimin e prioritetëve dhe politikave të qeverisë shqiptare. Ka qenë një ndër vitet me arritje më të rëndësishme në shumë sektorë të zhvillimit ekonomik. Kryefjala e vitit 2024 ka qenë mbi të gjitha turizmi, zhvillimi infrastrukturor, ka qenë viti i reformës së suksesshme në fushën e dixhitalizimit të shërbimeve dhe padyshim viti i rritjes së ndjeshme të pagave.

Më poshtë gjeni të analizuar punën e secilit sektor të Institucionit të Prefektit.

1. SEKTORI JURIDIK

1. HYRJE

1.1 Struktura

Sektori Juridik i Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan, në bazë të urdhrit të Kryeministrit nr.5 datë 12.01.2016 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së administratës së Prefektit të Qarkut Elbasan”, përbëhet nga: 1 Përgjegjës Sektori dhe 2 Specialist, përkatësisht:

- Përgjegjës Sektori Andi Grykshi
- Specialist (juriste) Anila Gremi
- Specialist (juriste) Silvana Vyshka

1.2 Detyrat

- Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, të ligjit nr.36/2024, datë 18.4.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, të urdhërit nr.50 datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së prefektit të qarkut”, të Rregullore së Brendshme të miratuar me urdhrin nr.67 datë 29.07.2020 “Mbi miratimin e Rregullores së Brendshme ‘Për funksionimin e administratës së Prefektit të Qarkut Elbasan’”, me të gjitha ndryshimet, sektori ka këto detyra:
 1. Verifikon ligjshmërinë e akteve të nxjerra nga organet e njësi të vetëqeverisjes vendore dhe përpilon dokumentacionin e nevojshëm duke u shprehur për ligjshmërinë e këtyre akteve, brenda afateve kohore.
 2. Përmbush detyrat në zbatim të funksioneve të deleguara për prefektin e qarkut dhe informon periodikisht për realizimin e tyre.

3. Kujdeset që ushtrimi i veprimtarisë së administratës së prefektit të qarkut të bëhet në përputhje me procedurat ligjore duke dhënë asistencën e nevojshme ligjore edhe për sektorët dhe zyrat e tjera të administratës së prefektit të qarkut.
4. Të gjitha praktikat shkresore që përgatiten nga administrata e prefektit të qarkut dhe që shprehen për mbështetje ligjore kontrollohen dhe siglohen nga juristët e këtij sektori.
5. Ndjek procedurat ligjore për konstituimin e organeve të zgjedhura të njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe sipas nevojës, procedurat për shpërndarjen apo shkarkimin e këtyre organeve.
6. Përgjegjësi i sektorit apo specialistët e tij me autorizim me shkrim të prefektit të qarkut përfaqësojnë institucionin në proceset gjyqësore në të cilat prefekti i qarkut është palë.
7. Mban një bazë të të dhënave me aktet ligjore, nënligjore, si dhe urdhrat e udhëzimet që nxjerr prefekti i qarkut.
8. Përgatit materiale të ndryshme në ndihmë të kualifikimit të administratës së prefektit të qarkut, si dhe për seminare apo takime me të zgjedhurit vendorë, sipas rastit.

2. USHTRIMI I DETYRËS GJATË VITIT 2024

2.1 Verifikimi i ligjshmërisë së akteve

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” është verifikuar ligjshmëria e akteve me karakter normativ të depozituara në zyrën e protokollit të institucionit nga organet e njëjësive të qeverisjes vendore, për vitin 2024 janë depozituar gjithësej - **673 akte**, më shumë krahasuar me vitin 2023 që ishin 650 akte, nga të cilët për vitin 2024 - **625 akte** janë konfirmuar, më shumë krahasuar me vitin 2023 që ishin 612 akte dhe për vitin 2024 janë kthyer **48 akte**, më shumë krahasuar me vitin 2023 që ishin 38 akte. Aktet kanë qenë të natyrave të ndryshme si: miratimi i buxheteve ndihma ekonomike, ndihma financiare, dhënie shpërblimi për shkak fatkeqësie natyrore, ndryshime në buxhet, ndryshim në paketën fiskale, miratimi i sistemit të pikëzimit për përfitimin nga programet e strehimit social, lista e përfituesve të programeve të strehimit social, dhënie tituj nderi, përcaktim emri të rrugëve, lidhur me linjat e transportit qytetëse dhe rrethqytetëse, për problematika në fushën e mbrojtjes së mjedisit, për administrimin e fondit pyjor, për miratim kërkesash për heqje sipërfaqesh të caktuara nga fondi pyjor për shkak të ndërtimit të HEC-eve, për shfrytëzim hapësirash publike etj.

Mendojmë se është e rëndësishme të sqarojmë se për disa nga aktet e kthyera janë kërkuar fillimisht të dhëna plotësuese dhe pas dërgimit të të dhënave të kërkuara shumica prej tyre janë konfirmuar dhe shumë pak prej tyre janë kthyer. Vazhdon të jetë problematik fakti që

aktet e depozituara në disa raste nuk kanë të bashkëngjitur relacionin shpjegues të drejtorisë përkatëse që ka hartuar projekt – aktin ose dokumente të tjera provues, që janë të domosdoshëm për verifikimin e ligjshmërisë së aktit, pasi njësitë e vetëqeverisjes vendore argumentojnë se informimi me detaje në lidhje me aktet e tyre është në kundërshtim me parimin e autonomisë vendore dhe Institucioni i Prefektit verifikon në parim ligjshmërinë e aktit.

Krahasuar me vitin 2023 këto raste janë më të pakta pasi organet e vetëqeverisjes vendore janë sensibilizuar duke plotësuar pothuajse aktet me dokumentat shoqëruese si dhe ndryshimi i ligjit konkretisht Neni 7 të ligjit nr.36/2024, datë 18.4.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” me atë që cilit është percaktuar dhe kërkohej që Aktet me karakter normativ të shoqërohen me një relacion përmbledhës të arsyeve për nxjerrjen e tyre, duke argumentuar për problematikat, qëllimet, objektivat që synohen të arrihen, përparësitë, si dhe efektet e pritshme nga miratimi, ka ndikuar pozitivisht.

Gjatë verifikimit në vend është vënë re se dosjet për aktet e miratuara në përgjithësi janë të plota me dokumentacionet përkatëse. Gjithsesi duhet të theksojmë se rastet që aktet nuk kanë dokumentacion bashkëlidhur janë sporadike pasi në bazë të konumikimit të vazhdueshëm zyrtar dhe të takimeve me Sekretarët e Këshillave, Kryetarët e Këshillave dhe të Bashkive është kuptuar se çdo akt duhet të ketë dokumentacion shpjegues bashkëlidhur, shumica e akteve të kthyera mbi ligjshmërinë kanë pasur të dhëna sqaruese jo të plota. Në rregulloren e miratuar me urdhrin nr.67 datë 29.07.2020 “Mbi miratimin e Rregullores së Brendshme “Për funksionimin e administratës së Prefektit të Qarkut Elbasan”, është parashikuar shprehimisht se çfarë dokumentacioni duhet të ketë çdo akt bashkëlidhur para shprehjes mbi ligjshmërinë e tij.

Disa nga aktet nuk janë kthyer tërësisht por pjesërisht disa pika të aktit. Në shumicën e rasteve aktet e kthyera kanë qenë të natyrës dhe kanë pasur këto problematika si më poshtë:

- Aktet për miratimin e masës së shpërblimit për familjet kanë pasur dëmtime materiale nga fatkeqësitë natyrore nuk janë konceptuar, hartuar, formuluar mirë, dokumentacioni bashkëlidhur, që duhet të dërgohet dhe pranë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes civile nuk ka qenë i plotë në disa raste etj
- Aktet për përcaktimin e listës së përfituesve nga programet e strehimit social të parashikuar në ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social”. Pas verifikimit të ligjshmërisë së këtyre akteve është vënë re se jo në të gjitha rastet respektohen kushtet e përcaktura nga ligji për përfitimin nga programet e strehimit social, kryesisht në lidhje me nivelin e të ardhurave të subjekteve përfituese, duke përfshirë në listë dhe subjekte që tejkalojnë nivelin maksimal të parashikuar nga ligji.

- Aktet për dhënie ndihme financiare për raste shëndetësore apo fatkeqësie është vërejtur se nuk shoqërohen me dokumentacionet përkatëse të cilat legjitimojnë shkakun për dhënien e kësaj ndihme. Në këto kushte i kemi kërkuar organeve të vetëqeverisjes vendore plotësimin e tyre.
- Në disa raste është vënë re se baza ligjore e akteve nuk është e përditësuar, kjo problematikë është hasur më shumë në aktet e Këshillit të Bashkisë Belsh, Peqin.
- Etj.

Krahasuar me vitin 2023 këto raste janë me të pakta pasi organet e vetëqeverisjes vendore janë sensibilizuar duke plotësuar mangësitë ligjore.

Gjithashtu vlerësojmë se është e rëndësishme të theksojmë se sikurse është referuar dhe më lartë në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Prefekti verifikon ligjshmërinë e akteve me karakter normativ, duke mos përfshirë aktet me karakter individual dhe kolektiv. Nga praktika e vendosur prej disa vitesh tanimë vihet re se njësitë e vetëqeverisjes vendore, kryesisht Këshillat depozitojnë akte të çdo natyre, në disa raste edhe organe të tjera vendose ose qendrore kërkojnë shprehjen e Prefektit mbi aktin (si një kontroll paraprak) para vazhdimin me proceduat përkatëse, prefekti është shprehur në lidhje me aktet e depozituara. Për sa më lartë kemi ndërmarrë nismën për nisjen e procesit të klasifikimit të akteve në individual, kolektiv dhe normativ dhe i kemi dërguar një shkresë organe të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për mos depozitim të disa prej akteve. Për shkak se klasifikimi i llojit të aktit nuk është i lehtë dhe duhet bërë rast pas rasti, nuk mund të hartohet një listë shteruese për secilën kategori akti mendojmë se duhet të fokusohemi më shumë në këtë drejtim, të ndihmojmë organet e njëjësive të vetëqeverisjes për identifikimin e saktë të tyre, krijim i një praktike të njëjtë e unifikuar nga të 12 Prefekturat për të mos u shprehur për aktet me karakter individual dhe kolektiv, për ti kthyer ato për shkak të mungesës së kompetencës.

Krahasuar me vitin 2023 këto raste janë më të pakta pasi organet e vetëqeverisjes vendore janë sensibilizuar duke dërguar vetëm aktet me karakter normativ.

2.2 Verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve

Në mbështetje të nenit 17 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” janë realizuar verifikimet në vend.

Lidhur me kete detyrim ligjor Prefekti për çdo verifikim ka ngritur Grupin e Verifikimit për ligjshmërinë e akteve me karakter normative drejtpërdrejt dhe sistematikisht në organin e njësisë së vetëqeverisjes vendore për Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan duke përfshirë cdo specialist për të verifikuar veprimtarinë, fushën e veprimit dhe të kompetencave të çdo sektori në institucionin e prefektit.

Verifikimi në vend është kryer duke respektuar procedurën e mëposhtme:

- a. Korrespondenca në kuadër të procesit të verifikimit midis prefektit të qarkut dhe njërive të vetëqeverisjes vendore është bërë në formë shkresore, kur nuk parashikohet ndryshe në ligj.
- b. Prefekti i qarkut me urdhër të veçantë ka caktuar grupin e punës, i cili ka kryer procedurën e verifikimit pranë njërive të vetëqeverisjes vendore duke përcaktuar dhe objektin e verifikimit.
- c. Grupi i punës ka filluar procesin e verifikimit me dërgimin e njoftimit, njësisë së vetëqeverisjes vendore në formë shkresore, i cili përmban:
 - njësinë e vetëqeverisjes vendore/subjektin e verifikimit;
 - bazën ligjore mbi verifikimin;
 - llojin e verifikimit;
 - arsyet e inicimit të verifikimit;
 - periudha që do të verifikohet;
 - afatet e kryerjes së verifikimit;
 - përbërjen e grupit të punës.
- d. Grupi i punës është përgjegjës për ndjekjen e procesit të administrimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit gjatë kryerjes së verifikimit në vend me qëllim evidentimin e të gjitha akteve me karakter normativ. Përpara se të nisi procesi verifikimit të ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave grupi verifikimit do të klasifikojë ato akte të cilat janë objekt verifikimi me karakter normative (sipas Ligjit Nr.44/2015 datë 30.04.2015, etj).
- e. Gjatë procesit të verifikimit në vend në institucionin e NJVV, grupi i punës mban një aktkonstatimi, i cili nënshkruhet dhe nga përfaqësuesit e NJVV-së, si dhe dorëzohet zyrtarisht dhe protokollohet në institucionin objekt verifikimi. Akti verifikimit duhet të përmbajë të gjitha elementët teknike, ligjore dhe financiarë të akteve të cilat janë objekt verifikimi me karakter normativ, duke evidentuar dokumentacionet mbi të cilat është miratuar (projekt-akti dhe dokumentat shoqëruese). Për aktet e kryetarit të bashkisë, zbatimi i tij dhe efektet të cilat ka sjellë, duke evidentuar dokumentacionet mbi të cilat është miratuar (projekt-akti dhe dokumentat shoqëruese). Për aktet e këshillit bashkiak procedura e ndjekur përpara miratimit (shqyrtimi në komisionet sipas rregullores së brendshme, dokumentacionet që legjitimojnë procedurën e njoftimit për zhvillimin e mbledhjes dhe njoftimin e këshilltarëve), miratimi në këshill duke evidentuar dokumentacionet mbi të cilat është miratuar (projekt-akti, procesverbali mbledhjes, pasqyrimi, votimi, zbardhja dhe shpallja e aktit), zbatimi i tij dhe efektet të cilat ka sjellë.
- f. Në rast se gjatë verifikimit në vend të ligjshmërisë grupi verifikimit konstaton akte, të cilat nuk janë depozituar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan, njofton zyrtarisht Prefektin i cili sipas procedurës së parashikuar në nenin 16, të këtij ligji, i kërkon Sektorit Juridik të përgatisë dokumentacionet ligjore me anë të së cilës do të kërkohet pavlefshmëria e tyre në gjykatën kompetente për çështjet administrative.

Përpara se të nisi procesi verifikimit të ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave, grupi verifikimit duhet të ketë një pasqyrë të saktë të akteve që janë depozituar në institucion gjatë periudhës objekt verifikimi.

- g. Në përfundim të procedurës së kryerjes së verifikimit në vend të akteve, grupi verifikimit përgatit konkluzionet së bashku me rekomandimet përkatëse dhe ia paraqet prefektit për miratim, një kopje e të cilave dërgohen pranë NJVV-së objekt verifikimi.
- h. Të gjitha dokumentacionet të cilat hartohen nga grupi verifikimit protokollohen dhe administrohen sipas ligjit për arkivat dhe akteve ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të tij.

Përgjegjësi i sektorit juridik në bashkëpunim me përgjegjësit e sektorëve të Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan kane hartuar programin e verifikimit duke specifikuar të gjitha elementët teknike dhe ligjore mbi verifikimin që do të kryhet dhe ia paraqesin Prefektit për miratim.

Përgjegjësi i sektorit juridik në bashkëpunim me përgjegjësit e sektorëve të Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan kane hartuar një model akt konstatimi duke specifikuar të gjitha elementët teknike dhe ligjore mbi mënyrën sesi do të kryhet verifikimi dhe sesi do të pasqyrohen të dhënat në këtë dokument dhe ia paraqesin Prefektit për miratim.

Janë kryer verifikime në Bashkinë Elbasan, Bashkinë Librazhd, Bashkinë Prrerjas, Bashkinë Peqin, Bashkinë Gramsh, Bashkinë Cërrik, Bashkinë Belsh dhe Këshillin e Qarkut Elbasan.

Është respektuar procedura duke dërguar fillimisht programin e kontrollit, hartimin e akt verifikimit dhe konkluzioneve, e rekomandimeve.

Janë ushtruar verifikime në vend të ligjshmërisë së akteve normative të Kryetarëve dhe Këshillave të Bashkivë të qarkut Elbasan nga Institucioni Prefektit të Qarkut Elbasan për 9 mujorin e vitit 2024 në zbatim të urdhërave të Prefektit përkatësisht:

Bashkia Elbasan 106 vendime

Këshilli i Qarkut 26 vendime

Bashkia Librazhd 94 vendime

Bashkia Peqin 30 vendime

Bashkia Cërrik 61 vendime

Bashkia Belsh 45 vendime

Bashkia Prrerjas 67 vendime

Bashkia Gramsh 50 vendime

Tremujori i kater per vitin 2024 do te kryhet ne muajin shkurt.

Nga verifikimi i dokumentacioneve pranë Këshillave Bashkiakë për miratimin e akteve të rezultojn se janë respektuar dispozitat e ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” me të gjitha ndryshimet, procedurat e ndjekura lidhur me shpalljen e akteve të miratuara, dokumentacionet, afatet, zbardhja e akteve të miratuara është bërë në bazë të pasqyrimeve në proces–verbalet e mbledhjeve dhe materialeve përkatëse të paraqitura në mbledhje. Nga verifikimi i dokumentacioneve për miratimin e akteve të Këshillave Bashkiakë rezultojn se Rregulloret e Brendshme të funksionimit të Këshillave janë zbatuar në respektim të dispozitave të saj në lidhje me siglimin e procesverbaleve të mbledhjeve etj.

Nga verifikimi i dokumentacioneve që ndodhen pranë Këshillave Bashkiakë për miratimin e akteve rezultojn se aktet normative kanë përmbushur qëllimet, objektivat që synohen të arrihen, përparësitë, si dhe efektet e pritshme nga miratimi dhe zbatimi i tyre në funksion të kompetecave që vetë Këshillat Bashkiakë kanë dhe në respekt të akteve ligjore që rregullojnë veprimtarinë e tyre.

Nga verifikimet e kryera problematika e vetme e konstatuar lidhet me mosfunksionimin e Komisioneve të Përherëshme të Këshillave të cilët përgjithësisht nuk janë mbledhur për shqyrtimin e projekt-vendimeve. Kjo problematikë e konstatuar është ngritur dhe nga njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat kanë kërkuar zgjidhjen e saj në respekt të zbatimit të Rregulloreve të Brendshme të miratuara për funksionimin e tyre.

Krahasuar me vitin 2023 problematikat janë më të pakta pasi organet e vetëqeverisjes vendore janë sensibilizuar duke i dhënë rëndësi anës dokumentare, organizimit dhe funksionimit të strukturave të bashkisë dhe të strukturave.

2.3 Shqyrtimi i ankesave ose kërkesave të subjekteve fizik ose juridik

Gjatë vitit 2024 në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan kanë paraqitur ankesë ose kërkesë **57 subjekte fizik ose juridik**, më pak krahasuar me vitin 2023 që ishin **71** subjekte fizik ose juridik. Ankesat ose kërkesat kanë qenë të natyrave të ndryshme si:

- Kërkesa për punësim
- Kërkesa për përfshirje në programet e strehimit social
- Lirim rruge
- Mosveprim ose veprime në kundërshtim me ligjin të degëve territoriale ose të organeve të vetëqeverisjes vendore
- Informacion në lidhje me vendime të KVVTP
- Ankesa për vendime të Këshillit të Bashkisë

Kërkesat/ankesat janë trajtuar nga sektori juridik ose nga sektorët e tjerë në bazë të natyrës së problemit. Për të gjitha ankesa/kërkesat është ndjekur procedura administrative duke ju drejtuar institucionit kompetent për trajtimin e problemit, kërkesës për paraqitje të subjektit dhe pritjes së tij nëse kërkohet më shumë informacion, kërkesës për plotësim të të dhënave brenda një afati të arsyeshëm nëse kërkesa nuk ka qenë e qartë ose kanë munguar të dhënat, kthim përgjigje në lidhje me mënyrën e zgjidhjes.

Në kuadrin e verifikimeve të ankesave, problemeve dhe shqetësimeve të ardhura në Institucionin e Prefektit nga shtetas të ndryshëm Prefekti ka bërë përveç trajtimin Institucional të këtyre ankesave në respekt të ligjit për Kodin e Proedurës Administrative dhe akteve të tjera ligjore duke i kërkuar institucioneve qendrore apo vendore ndaj të cilave janë drejtuar ankesat, por edhe verifikimin në vend të shumë prej tyre për të parë më nga afër problemin dhe për të gjetur të drejtën dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre.

Njëkohësisht është për tu evidentuar se gjatë vitit 2024 në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan janë depozituar edhe 300 dokumentacione me anë të së cilave janë përcjellë informacione mbi veprimtaritë e degëve territoriale, vetëqeverisjes vendore, etj që janë përpunuar dhe verifikuar nga ana jonë për të krijuar një ekspozitë të qartë lidhur me detyrat, realizimin e tyre, problematikat e ndryshme dhe masat që duhet të merren për Qarkun Elbasan.

Ulja e numrit ankesë ose kërkesave gjatë vitit 2024 në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan në gjykimin dhe konstatimeve tona ka të bëjë me mirëorientimin e shtetasve në drejtim të institucioneve ku ata kanë problemet ose ku mund të kërkojnë zgjidhjen e tyre.

2.4 Akte nënligjore, urdhra, vendime, udhëzime të miratuara nga Prefekti

Në mbështetje të ligjit organik, në zbatim të funksioneve të deleguara, gjatë vitit që lamë pas 2024 janë miratuar **151 urdhra dhe 1 vendim** nga Prefekti i Qarkut Elbasan, më shumë krahasuar me vitit 2023 që ishin 139 urdhra, dhënie shpërblimi, si dhënie leje të zakonshme, lirim nga detyra, emërim në detyrë, transferim në detyrë, ngritje grupi pune, delegim kompetencash, krijim i komisionit për procedurën e rekrutimit me lëvizje paralele etj.

Më poshtë po ju listojmë disa nga urdhrat më të rëndësishëm.

- Urdhër nr.7 datë 16.01.2024 “Mbi ngritjen e komisionit te menaxhimit te riskut per institucionin e prefektit qarkut Elbasan”
- Urdhër nr.8 datë 16.01.2024 “Per ngritjen e komisionit te menaxhimit te buxhetit te vitit 2024 per institucionin e prefektit qarkut Elbasan”

- Urdhër nr.9 datë 16.01.2024 “Per ngritjen e komisionit per hartimin dhe realizimin e regjistrit te parashikimit te prokurimeve publike te buxhetit te vitit 2024 per institucionin e prefektit qarkut Elbasan”
- Urdhër nr.20 datë 22.01.2024 “Mbi kontrollin, monitorimin e veprimtarise dhe bashkerendimin e punes se degeve territoriale, agjencive dhe inspektoratet qe veprojne ne qarkun Elbasan”
- Urdhër nr.2 datë 05.02.2024 “Për emërim në detyrë”
- Vendim nr.4 datë 13.03.2024 “Për konfirmimin e nepunesit civil”
- Urdhër nr.42 datë 12.04.2024 “Per ngritjen e grupit te punes per monitorimin dhe kontrollin e kontratave te qerave, objekteve te dhena me qera dhe ambienteve te lira, te cilat jane ne administrim dhe pergjegjesi te institucionin te prefektit qarkut Elbasan”
- Urdhër nr.51 datë 17.05.2024 “Per ngritjen e organit keshillues prane Prefektit Qarkut Elbasan”
- Urdhër nr.52 datë 21.05.2024 “Mbi disa ndryshime dhe shtesa ne rregulloren e brendshme per funksionimin e administrates se Prefektit Qarkut Elbasan”
- Urdhër nr.54 datë 29.05.2024 “Per ngritjen e task-forces lokale per sezonin turistik veror 2024 ne Qarkun Elbasan”
- Urdhër nr.61 datë 19.06.2024 “Për zevendesimin e orarit zyrtar te punes”
- Urdhër nr.68 datë 05.07.2024 “Mbi ndryshimet e nivelit te pagave sipas struktures organizative te aparatit te administrates të Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan”
- Urdhër nr.82 datë 18.07.2024 “Mbi menyren e dergimit te dokumentacioneve te cilat dalin nga Institucioni i Prefektit Qarkut Elbasan”
- Urdhër nr.83 datë 22.07.2024 “Mbi organizimin e sherbimit te transportit per Institucionin e Prefektit Qarkut Elbasan”
- Urdhër nr.81 datë 18.07.2024 “Mbi verifikimin e akteve me karakter normativ te bashkive te qarkut Elbasan te depozituara ne Institucionin e Prefektit Qarkut Elbasan”
- Urdhër nr.88 datë 23.07.2024 “Mbi ndryshimet e nivelit te pagave te nepunesve te zyrave te gjendjes civile”
- Urdhër nr.96 datë 06.08.2024 “Per ngritjen e komisionit per hartimin e projekt-buxhetit te vitit 2025-2027”
- Urdhër nr.100 datë 15.08.2024 “Per vleresimin e gjendjes teknike te automjeteve te Institucionit per vitin 2024”
- Urdhër nr.104 datë 30.08.2024 “Per caktimin e perfaqesuesve te institucionit ne cilesine e sekretariatit teknik KRAT Elbasan dhe si persona pergjegjes per monitorimin e planit kombetar te veprimit per Luften kunder Trafikimit te Personave 2024-2025”

- Urdhër nr.105 datë 30.08.2024 “Per ngritjen e komisionit per verifikimin e dokumentacioneve arkivore te cilat ndodhen ne Nenprefektoren Peqin, Institucioni Prefektit te Qarkut Elbasan”
- Urdhër nr.106 datë 02.09.2024 “Per ngritjen e grupit te punes per monitorimin, kontrollin e zbatimit te kontratave te qerave, objekteve te dhena me qera, si dhe evidentimin e ambjenteve te lira te cilat jane ne administrim dhe pergjegjesi te Institucionit te Prefektit te Qarkut Elbasan”
- Urdhër nr.110 datë 06.09.2024 “Per ngritjen e grupit te verifikimit per ligjshmerine e akteve me karakter normative drejtperdrejt dhe sistematikisht ne organin e njesise se eteqeverisjes vendore per Institucionin e Prefektit te Qarkut Elbasan”
- Urdhër nr.117 datë 13.09.2024 “Emerim sipas struktures organizative te aparatit te administrates se Prefektit te Qarkut Elbasan”
- Urdhër nr.137 datë 16.12.2024 “Per ngritjen e komisionit te brendshem per zhvillimin e procedures se intervistes per pozicionin “Specialist ne sektorin e monitorimit te kompetencave vendore dhe funksioneve te deleguara” per Prefektin e Qarkut Elbasan”
- Urdhër nr.148 datë 27.12.2024 “Per ngritjen e komisionit per kryerjen e inventarizimit te vlerave materiale per vitin 2024 ne Institucionin e Prefektit te Qarkut Elbasan dhe Nenprefekturat Librazhd, Gramsh, Peqin”.

2.5 Kujdesi që ushtrimi i veprimtarisë së administratës së prefektit të qarkut të bëhet në përputhje me procedurat ligjore

Me qëllim që veprimtaria e administratës dhe prefektit të ushtrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, për nëpunësit e administratës është dhënë shërbim juridik në rastet kur ka qenë e nevojshme, janë informuar për ndryshimet e akteve ligjore ose nënligjore që kanë lidhje me veprimtarinë e institucionit, të njëjstëve të vetëqeverisjes vendore ose degëve territoriale.

Të gjitha shkresat siglohen nga specialistët ose përgjegjësi i sektorit juridik.

2.6 Bashkërendimi, monitorimi, raportimi mbi veprimtarinë e degëve territoriale

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, me te gjitha ndryshimet, të urdhrit nr.95 datë 07.10.2020 “Për caktim detyrash”, i ndryshuar sektori juridik është përgjegjës për monitorimin e veprimtarisë së degëve territoriale, drejtorive rajonale që veprojnë në fushën e shëndetësisë. Këto drejtori janë: Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Elbasan, Librazhd, Gramsh, Peqin, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Elbasan, Librazhd, Gramsh, Peqin,

Drejtoria Rajonale e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Dega Rajonale e Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor. Gjatë vitit 2024 janë kërkuar rregullisht informacione në lidhje me veprimtarinë e këtyre institucioneve është dërguar raporti 6 mujor dhe vjetor pranë ministrisë përgjegjëse.

2.7 Prokurimet për vitin 2024

Gjatë vitit 2024 Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan ka zhvilluar një sërë procedurash të prokurimeve publike në zbatim të buxhetit të miratuar për këtë vit, ku një rol të rëndësishëm për kryerjen e tyre ka pasur sektori juridik. Proçedurat e kryera për vitin 2024 rezultojnë si më poshtë vijon;

Nr.	Objekti i Prokurimit	Tipi i kontratës	Lloji i regjistrit të prokurimit	Fondi i përlogaritur
1	Rikonstruksion te godines dhe zyrave te Institucionit te Prefektit Qarkut Elbasan	Punë	Procedure Prokurimi	816666.67
2	Sherbime te verifikimit te gjendjes teknike, inxhinierike, te mjetit te amortizuar ne pronesi te institucionit	Shërbime	Blerje nen vleren 100 000 Leke	10000.00
3	Për blerje shërbime pastrimi për zyrat e N/prefekturave Gramsh, Peqin, Librazhd	Shërbime	Procedure Prokurimi	610163.40
4	Blerje Karburant, Naftë	Mallra	Procedure Prokurimi	550000.00
5	Blerje kondicionere per zyra	Mallra	Blerje nen vleren 100 000 Leke	41666.67
6	Sherbim riparimi kondicioneresh	Shërbime	Blerje nen vleren 100 000 Leke	80000.00
7	Sherbim per larje automjeti	Shërbime	Blerje nen vleren 100 000 Leke	75000.00
8	Blerje sherbim sigurimi te detyrueshem automjeti	Shërbime	Blerje nen vleren 100 000 Leke	37000.00

9	Sherbime Kolaudimi te punimeve per proçeduren me objekt: Rikonstruksion të godinës dhe zyrave te Institucionit te Prefektit Qarkut Elbasan	Shërbime	Blerje nen vleren 100 000 Leke	6666.67
10	Mirembajte objekte ndertimore, lysterje, etj	Shërbime	Blerje nen vleren 100 000 Leke	68333.33
11	Sherbime dizifektimi etj	Shërbime	Blerje nen vleren 100 000 Leke	41666.67
12	Sherbime per mirembajtje Web faqe zyrtare, publikime, etj	Shërbime	Blerje nen vleren 100 000 Leke	100000.00
13	Blerje materiale kancelarie, stilolapsa, lapsa, korrektues, leter A4, etj.	Mallra	Blerje nen vleren 100 000 Leke	100000.00
14	Blerje kompjuter per zyra	Mallra	Blerje nen vleren 100 000 Leke	80000.00
15	Shpenzime mirembajtje te rrjeteve hidraulike, elektrike, etj	Shërbime	Blerje nen vleren 100 000 Leke	100000.00
16	Blerje dokumentacioni etj	Mallra	Blerje nen vleren 100 000 Leke	16666.67
17	Blerje pjese kembimi e bateri, filtra, vaj per automjete, etj Furnizim Vendorsje	Mallra	Procedure Prokurimi	196666.67
18	Supervizim, mbikqyrje i punimeve per proçeduren me objekt: Rikonstruksion të godinës dhe zyrave te Institucionit te Prefektit Qarkut Elbasan	Shërbime	Blerje nen vleren 100 000 Leke	10000.00
19	Blerje Materiale per funksionimin e paisjeve te zyrës, Toner	Mallra	Blerje nen vleren 100 000 Leke	100000.00
20	Blerje materiale per sherbime	Mallra	Blerje nen vleren 100 000	23333.33

	speciale per parandalimin e zjarrit, etj		Leke	
21	Mirembajtje objekte ndertimore, lysterje, etj	Shërbime	Blerje nen vleren 100 000 Leke	31666.67
22	Sherbime per lidhjen dhe sistemimin e librave te gjendjes civile etj	Shërbime	Blerje nen vleren 100 000 Leke	25000.00
23	Materiale Furnizime te tjera zyre e te pergjithshme	Mallra	Blerje nen vleren 100 000 Leke	20000.00
24	Shpenzime per mirembajtje paisje zyre, elektronike, etj	Shërbime	Blerje nen vleren 100 000 Leke	100000.00
25	Blerje materiale e furnizime te tjera zyre te pergjithshme si brava dhe fisheke dere, kartolina, rafte, etj	Mallra	Blerje nen vleren 100 000 Leke	80000.00
26	Blerje materiale pastrimi, etj	Mallra	Blerje nen vleren 100 000 Leke	100000.00
27	Shërbime gjelberimi, kopesharise per sistemimin e lulishtet para objektit te prefektures dhe mbjelljen me lule dhe peme te reja, etj	Shërbime	Blerje nen vleren 100 000 Leke	78983.33
28	Blerje materiale per sherbime speciale per parandalimin e zjarrit, etj	Mallra	Blerje nen vleren 100 000 Leke	60000.00
29	Sherbim interneti dhe telefoni per vitin 2024	Shërbime	Blerje nen vleren 100 000 Leke	100000.00
30	Sistemim, vizim, te sheshit te parkimit perpara institucionit ne administrim te Institucionit te Prefektit	Shërbime	Blerje nen vleren 100 000 Leke	90000.00
31	Shpenzime per mirembajtje te pajisjeve te teknike etj	Shërbime	Blerje nen vleren 100 000 Leke	16666.67

2.8 Ndjekja e proceseve gjyqësore

Në vitin 2024 kanë qenë 10 procese gjyqësore, pothuajse njelloj sa në vitin 2023 që ishin po 10 procese gjyqësore.

Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan, për vitin 2024 ka qenë i paditur në **1** proces gjyqësore, proces gjyqësor për kërkim detyrimesh lidhur me kontratat e telefonisë celulare i cili është në shqyrtim dhe vazhdon si proces gjyqësor, në **1** proces gjyqësore kemi qenë si palë e paditur dhe jemi përfshirë si palë të paditur lidhur me shprehjet e prefektit mbi aktet e këshillave bashkiakë, i cili është në shqyrtim dhe vazhdon si proces gjyqësor, kemi paraqitur **2** kërkesë padi lidhur me marrëdhëniet e punësimit me ish-punonjës të PMNZSH-së të qarkut Elbasan, dhe **1** kërkesë padi për kundërshtim detyrimesh tatimore, procese të cilat janë në vazhdim, **1** kërkesë padi lidhur me pavlefshmëri të akteve të këshillave bashkiakë, proces që ka perfunduar dhe jemi ne pritje te venies ne dispozicion te vendimit te zbardhur te gjykates per te vazhduar me tej me hapat e tjere, proces i fituar nga ana jone, **1** proces gjyqësor i cili është akoma në shqyrtim lidhur me kontratat e shitjeve të bera nga ish-këshilli i rrethit Elbasan, **1** proces gjyqësor për kërkim detyrimesh lidhur me detyrime që i janë faturuar ish-këshillit të rrethit Gramsh, si dhe jemi si pale e paditur ne **2** procese gjyqësore ne lidhje me kerkesat e shtetasve per te cilat kërkohen detyrimi i palës së paditur për ta trajtuar palën paditëse sipas ligjit për emergjencat civile, etj, procese te cilat jane ne vazhdim.

Me prokurorinë në institucionin tonë janë drejtuar disa kërkesa për informim në lidhje me ankesa të ndryshme të shtetësave, sesi janë trajtuar në rrugë administrative dhe çfarë zgjidhje apo drejtimi ligjor i kemi dhënë, dhe për të gjitha këto kërkesa i jemi përgjigjur në kohë prokurorisë duke i dërguar edhe dokumentacionet përkatëse që disponojmë për to.

2.9 Shqyrtimi, delegimi deri në zgjidhjen e problematikave të adresuara nga organet qëndrore në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan.

Në vitin 2024 kanë qenë 13 praktika, më pak se në vitin 2023 që ishin 15 praktika.

Gjatë vitit 2024 në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan dhe konkretisht të shqyrtuara nga Sektori Juridik janë përcjellë 13 praktika me objekt “Për njohje dhe zbatim”, “Kërkesë për informacion”, “Verifikim ankesë”, Vendime të Këshillit të Ministrave “Për zbatim dhe ndjekje”.

Të gjitha praktikat janë trajtuar nga sektori juridik në bazë të natyrës së problemit. Për të gjitha është ndjekur procedura administrative deri në zgjidhjen e tyre.

Në kuadrin e verifikimeve të ankesave, problemeve dhe shqetësimeve të ardhura në Institucionin e Prefektit nga Ministria e Brendshme, Prefekti ka bërë përveç trajtimit Institucional të këtyre ankesave në respekt të ligjit për Kodin e Proedurës Administrative

dhe akteve të tjera ligjore duke i kërkuar institucioneve vendore apo degëve territoriale ndaj të cilave janë drejtuar ankesat, por edhe verifikimin në vend të shumë prej tyre për të parë më nga afër problemin dhe për të gjetur të drejtën dhe mënyren e zgjidhjes së tyre.

3. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2025

- ▶ Koordinimi i punës së Sektorit Juridik me degët territoriale për zbatimin e programeve të Këshillit të Ministrave.
- ▶ Ndjekja e procedurës administrative për ankesat ose kërkesat e subjekteve fizik ose juridik.
- ▶ Ndihma e nëpunësve të administratës së Institucionit të Prefektit për zbatimin e detyrave dhe Prefektit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Propozimin e marrjes së masave konkrete, brenda afateve për zbatimin e ligjit.
- ▶ Rritja e bashkëpunimit midis Sektorit dhe Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, duke organizuar dhe seminare ose takime informuese nëse do të jetë e nevojshme.
- ▶ Ngritja dhe funksionimi i TASK-FORCAVE në nivel vendor për probleme të ndryshme dhe përpunimi i informacioneve në përfundim të veprimtarisë së tyre.
- ▶ Respektimi dhe plotësimi i detyrimeve ligjore në lidhje me rolin e Institucionit të Prefektit në procesin zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025.

2. SEKTORI I ADMINISTRIMIT FINANCIAR

Kjo zyrë ka në përbërje të saj 7 punonjës;

- a. 1 përgjegjës sektori
- b. 4 specialistë (2 specialiste finance, 1 specialist për burimet njerëzore, 1 specialist arkiv-protokolli dhe 2 punonjës të shërbimeve mbështetëse (sanitare dhe shofer) të cilët kanë qenë të fokusuar në plotësimin e detyrave që i ngarkohen Institucionit të Prefektit bazuar në legjislacionin në fuqi dhe rregullores së Institucionit. Punonjësit e financës kanë punuar në zbatim të kërkesave të ligjit nr.9936 dt.26.06.2008”Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit Nr.97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.1, datë. 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024” të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe të Udhëzimit nr.459 dt.16.08.2013 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit në sistemin e Ministrisë së Brëndshme”, të akteve të tjera nënligjore si dhe të ligjit nr.10296 dt.08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe VKM-të dhe Urdhërat në zbatim të tij.

Gjatë kësaj periudhe sektori i administrimit financiar ka plotësuar detyrat e ndërlidhura me degën e Thesarit Elbasan, në lidhje me zbatimin e buxhetit të Institucionit të Prefektit të

Qarkut Elbasan, si dhe ka dhënë ndihmesë në përdorimin e drejtë të fondeve buxhetore si paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore dhe shpenzime operative. Gjatë këtij viti ashtu si dhe në vite të tjera ka qenë në qendër të vëmëndjes:

1. Ndjekja e treguesve të buxhetit të deleguar dhe atij të pavarur.

2. Është kryer rregullisht, brenda afateve të përcaktuara në udhëzimet për zbatimin e buxhetit, rakordimi me degën e thesarit të rrethit për të ardhurat dhe shpenzimet mujore dhe progresive për çdo zë të shpenzimeve, për të dy programet buxhetore. Brenda datës 5 të çdo muaji është raportuar në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Brendshme dhe tek Drejtuesi i programit Buxhetor, informacioni për të dhënat operative për realizimin e zërave kryesore të buxhetit.

3. Është zbatuar ligjshmëria në lidhje me hartimin e listpagesave të punonjësve për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore, janë respektuar të gjitha afatet për deklarimin online të detyrimeve për sigurime shoqërore e shëndetësore dhe të tatimit mbi të ardhurat personale.

4. Administrimi i fondeve të administratës së Prefektit. Në këtë drejtim është bërë kujdes që me fondet në dispozicion të mbajë në efikasitet një administratë efikase dhe me kosto të ulët.

5. Sektori i Financës që në fillim të vitit 2024, u angazhua në detajimin e fondeve buxhetore të akorduara për vitin 2024, duke paraqitur sa më saktë nevojat e Institucionit të Prefektit për të dy programet buxhetore, Aparat, dhe Gjendje Civile, në nivel titull, kapitull, artikull e n/artikull.

6. Është përpiluar rregjistri i parashikimit të prokurimeve publike për vitin 2024, mbi bazën e të cilit janë realizuar të gjitha prokurimet publike të blerjeve me vlera të vogla të planifikuara, duke respektuar limitet, në zbatim të ligjit për prokurimet publike. Nga fondet e vëna në dispozicioni për Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan janë realizuar **35** prokurime me vlera të vogla të tipit kancelari, bojra printer, materiale pastrimi, siguracion automjetesh, pjese këmbimi, mirembajtje pajisje zyre , blerje dokumentacioni, filtra dhe vaj, taksa vendore etj.

7. Me qëllim menaxhimit financiar eficient të fondeve të buxhetit të Institucionit, për programin e Aparatit si dhe parandalimin e krijimit të detyrimeve të palikuiduara në kohë, për vitin 2024, janë marrë të gjitha masat për evidentimin e çdo detyrimi, duke verifikuar saktësinë e faturave, dokumentacionit justifikues të çdo fature dhe likuidimin e tyre brenda 30 ditëve në zbatim të ligjit 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e Tregtare”, për vitin 2025 nuk kemi detyrime të prapambetura, janë krijuar nga zbardhja e vendimit të Gjykatës Administrative nr. regjistri.83 datë 04.02.2019 (nr.1 datë 16.04.2024), në vlera e mbetur e detyrimit është 398 473 lekë

8. Prioritet i Sektorit të Financës ka qenë garantimi, para miratimit të urdhërave me karakter financiar, i zbatimit të ligjshmërisë, rregullshmërisë dhe respektimit të parimeve të

ekonomicitetit, efijencës dhe efektifitetit të shpenzimeve. Ndjekja e çmimeve të tregut dhe përlllogaritja e kostove për çdo prokurim të realizuar për blerjet me vlera të vogla

9.Realizimi i buxhetit për vitin 2023 në krahasim me vitin 2024 paraqitet si më poshtë:

Perdorimi I fondeve per administraten e Prefektit								
2023					2024			
Llogaria ekonomike	Plan	Fakt	Diferenca	Realizimi ne %	Plan	Fakt	Diferenca	Realizimi ne %
Paga (600)	26,655	26,025	630	98	32,796	31,916	880	97
Sigurime Shoqerore (601)	4,753	4,304	449	91	5,530	5,299	231	96
Shpenzime operative (602)	8,000	7,923	77	99	7,879	7,823	56	99
Transferta per buxhetin (606)	170	170	0	100	547	547	0	100
Shpenz. Per rritje te AQ (231)	0	0	0	0	1,000	996	4	100
TOTALI	39,578	38,422	1,156	97	47,752	46,581	1,171	98

Perdorimi I fondeve per administraten e Gjendjes Civile								
2023					2024			
Llogaria ekonomike	Plan	Fakt	Diferenca	Realizimi ne %	Plan	Fakt	Diferenca	Realizimi ne %
Paga (600)	4,170	4,122	48	99	5,148	5,135	13	100
Sigurime Shoqerore (601)	720	693	27	96	846	846	0	100
Shpenzime operative (602)	0	0	0	0	30	30	0	100
Transferta per buxhetin (606)	0	0	0	0	0	0	0	0
TOTALI	4,890	4,815	75	98	6,024	6,011	13	100

Në total Buxheti i Institucionit të Prefektit është realizuar në masën 99%

10.Ndërsa në lidhje me fondet për investimet, në buxhetin e vitit 2024 është akordua një fond me destinacion rikonstruksion godine, blerje orendish apo blerje pajisje në vlerën 1 000 000 lekë, referuar me një vit më parë ku nuk kemi pasur fonde për investime, me të cilën përmbushëm sado pak nevojat e institucionit.

Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan ka nevojë për blerje pajisje dhe orendi zyre , sepse një pjesë e pajisjeve kompjuterike si dhe printera të cilat janë në përdorim janë teje e amortizuar dhe si rrjedhojë dhe luhatjet e tensionit elektrik si dhe ulja e automateve shkakton dhe ka shkaktuar dëme deri në mos funksionimin e këtyre pajisjeve.Një pjesë e tyre në rast difekti, nuk është marrë përsipër për rregullim pasi janë teje të vjetra dhe serviset nuk disponojnë materiale për regullimin e tyre apo dhe kostoja për rregullim e tyre tejkalon vlerën reale të pajisjeve.Nevojë kjo e paraqitur dhe vit pas viti në dërgimin e materialit të dërguar të PBA-së.

11.Nga ana Sektorit të Financës janë marrë të gjitha masat për evidentimin dhe pasqyrimin në kontabilitet të të gjitha transaksioneve financiare, detyrimeve debitore dhe kreditore, duke likuiduar plotësisht te gjitha detyrimet e krijuara gjate vitit 2024.

12.Gjatë vitit është kryer hartimi i dokumentacioneve përkatëse për prokurimet me blerje të vogla për likuidimin e faturave dhe detyrimeve të ndryshme ndaj te tretëve, duke filluar që nga pergatitja e urdhër prokurimeve, proces-verbaleve të ndryshme, fletë hyrjeve, fletë daljeve, hartimin e urdhër-pagesave, regjistrimin në ditarin e magazinës, regjistrimin e harxhimit të karburantit ne bazë të fletë daljeve. Është kryer përlllogaritja, regjistrimi i pagave për çdo muaj për punonjësit si dhe xhirimi i pagave në bankë.

13.Përsa i takon të ardhurave të arkëtuara nga institucioni ynë gjatë vitit 2024 janë arkëtuar gjithsej:

- 1) 178 093 lekë për vitin 2024 në krahasim me vitin 2023 në vlerën 161 415 lekë për qera objekti, 10 % më tepër se një vit më parë.
- 2) 1 246 lekë për vitin 2024 në krahasim me vitin 2023 në vlerën 580 lekë kamatvonesa 215 % më tepër se një vit më parë, c'ka nënkupton që detyrimet janë paguar në kohë reale.
- 3) 205 lekë për vitin 2024 në krahasim me vitin 2023 në vlerën 41 220 lekë për takse te akteve te pulles, 100 % më pak se një vit më parë, për arsye se prej 1 Shtatorit 2023 shërbimi për nxjerrjen e certifikatave ka kaluar online.

-Të ardhura gjithësej për vitin 2024 kanë qenë në vlerën **183 439 lekë në krahasim me një vit më parë që ka qene 203 215 lekë pra 10% më pak se një vit më parë**. Për të ardhurat e mbledhura nuk na është dhënë e drejta për përdorim që prej vitit 2007 sipas shkresës nr.11442 dt.03.11.2008 “Sqarim procedurë për përdorimin e Kap.5 për institucionet e MB”, pika 6 ku sqarohet që Degët e Thesarit në Rrethe nuk do të bëjnë rritje të autorizuar sipas procedurave normale të shpërndarjes së të ardhurave.Pra nuk lejohet përdorimi i të ardhurave të realizuara pranë këtyre njësive vartëse të MB.

14.Gjithësej vlera e faturave për arkëtim nga kamatvonesat të paarkëtuara për periudhën Janar-Dhjetor 2024 nga qerate është 0 leke.

15.Në mbështetje të Ligjit Nr. 9228, datë 30.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, janë rregjistruar të gjitha transaksionet në mënyrë kronologjike, mbështetur në dokumentat bazë, në librat e llogarive, në ditarët analitik, në librat ndihmës dhe janë përpiluar pasqyrat financiare të Institucionit. Është zbatuar afati për dorëzimin e tyre në degën e thesarit dhe në Drejtorinë e Financës në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

16.Në zbatim të Udhëzimit “Për përgatitjen e Buxhetit Afatmesëm 2025-2027”, është dërguar në Ministrinë e Punëve të Brendshme Projekt Buxheti 2025-2027.Në zbatim të Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afat-Mesëm 2025-2027”,u hartua për të dy programet, Projekt - Buxheti afatmesem 2025-2027, bazuar në faktin e vitit 2024 dhe kërkesat e Institucionit për vitin në vazhdim.

17. Në zbatim të Ligjit Nr.9228 dt.29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të Vendimit nr.25 dt.20.02.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.248 dt.10.04.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe njësitë që varen prej tyre”, të Udhëzimit nr.8, dt.09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, të Udhëzimit Nr.31, dt 13.12.2023 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2023” të Ministrisë së Financave, brenda datës 31 Mars 2024 janë përpiluar pasqyrat financiare të Institucionit. Është zbatuar afati për dorëzimin e tyre në degën e thesarit dhe në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Brendshme.

18. Ligji Nr.97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.1, datë. 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024” të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ka ndjekur verifikimin e ligjshërisë së Vendimeve të KB për miratimin dhe zbatimin e buxheteve vendore gjatë gjithë periudhës ushtrimore.

Burimet njerëzore

NR	KATEGORIZIMI SIPAS FUNKSIONIT	EMERTIMI I POZICIONI	STRUKTURA PLAN	STRUKTURA FAKT	REKRUTIME GJATE VITIT	POZICIONE VAKANTE
1	FUNKSIONET POLITIKE	Prefekt	1	1	1	0
		Nenprefekt	3	3	0	0
2	FUNKSIONET E SHERBIMIT CIVIL	Sekretar I Pergjithshem	1	1	1	0
		Pergjegjes Sektori	5	4	0	1
		Specialist	16	14	0	2
3	FUNKSIONET ADMINISTRATIVE	Sekretar	1	1	0	0
		Shofer	1	1	0	0
		Punonjes pastrimi	1	1	0	0
		TOTALI	29	26	2	3
4	FUNKSIONE TE DELEGUARA	Pergjegjes Gjendjes Civile Elb	1	1	0	0
		Pergjegje Gjendjes Civile Rrethe	3	3	0	1
		TOTALI	4	4	0	4
		TOTALI GJITHSEJ	33	30	2	4

Administrata e prefektit të qarkut funksionon sipas strukturës të miratuar me urdhër Kryeministri.

Funksionet ndahen në: funksione politike, funksione të shërbimit civil dhe funksione administrative.

Numri total i pozicioneve sipas strukturës plan është 29 nga te cilat fakt janë 26 punonjës.

Pozicionet e punes të ndara sipas funksioneve, strukturës plan dhe asaj fakt janë si vijon:

	Plan	Fakt
a. Funkzionet politike:	4	4
i. Prefekti	1	1
ii. Nënprefekti	3	3
b. Funkzionet e shërbimit civil:	22	19
i. Sekretar i Përgjithshëm;	1	1
ii. Përgjegjës sektori.	5	4
iii. Specialist	16	14
c. Funkzionet administrative:	3	3
i. Sekretar	1	1
ii. Drejtues automjeti	1	1
iii. Punonjës pastrimi	1	1

Pozicionet vakante në **31.12.2023** kanë qenë 3, të gjitha nga funksionet e Shërbimit Civil, më konkretisht:

- ✓ 1 Sekretar i Përgjithshëm
- ✓ 1 Përgjegjës Sektori (Përgjegjësi i Sektorit të Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara)
- ✓ 1 Specialist (Specialist të Sektorit të Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara)

Ku gjatë vitit 2024 është kryer procedura e rekrutimit dhe është plotësuar pozicioni vakant i Sekretarit të Përgjithshëm. Pozicion tjetër vakant që është krijuar gjatë vitit 2024 është ai i Specialistit të Zhvillimit Urban. Pozicionet vakante janë shpallur në muajin Tetor 2024 pas përfundimit të procesit të ristrukturimit të institucionit dhe janë akoma në proces konkurimi.

Pozicione të tjera vakante që janë krijuar gjatë vitit dhe janë plotësuar po gjatë vitit janë:

- ✓ 1 Prefekt,

Pra në vitin 2024 janë kryer 2 rekrutime nga të cilat 1 pjesë e shërbimit civil dhe 1 pozicione politik, ndërkohë që në 2023 kemi pas 8 rekrutime në total nga të cilat 5 pjesë e shërbimit civil, 2 pozicione politike dhe 1 pozicione administrativ.

Pozicionet vakante në **31.12.2024** janë 3, të gjitha nga funksionete e Shërbimit Civil, më konkretisht:

- ✓ 1 Përgjegjës Sektori (Përgjegjësi i Sektorit të Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara)

- ✓ 2 Specialist (1 Specialist të Sektorit të Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara dhe 1 Specialist i Zhvillimit Urban)

Të gjitha pozicionet vakante janë në proces rekrutimi.

Gjithashtu, në përbërje të administratës kemi dhe funksione të deleguara, më konkretisht 4 Përgjegjës të Gjendjes Civile. Nga të cilët është 1 Përgjegjës i Gjendjes Civile Elbasan dhe 3 Përgjegjës të Gjendjes Civile në Rrethe. Nga Funksionet e deleguara kemi 1 pozicione vakante atë të Përgjegjës i Gjendjes Civile Gramsh, në pozicionin e të cilit është komanduar një punonjës deri në momentin e përfundimit të procedurës së konkurimit.

Së bashku me Funksionet e Deleguara numri total i Administratës së Prefektit të Qarkut Elbasan ,33 punonjës plan nga të cilët 30 punojës fakt.

- Të gjitha emërimet dhe lirimet e punonjësve të institucionit janë pasqyruar në sistemin HRMIS (Regjistri Qendror i Personelit), me të gjitha të dhënat profesionale dhe teknike të gjithësecilit. Si dhe është informuar Ministria e Brendshme dhe DAP-i për çdo levizje të punonjësve (emërimet / lirimet).
- Gjatë vitit 2024 nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan nuk është dhënë asnjë masë disiplinore, në krahasim me vitin 2023 që është dhënë 1 masë disiplinore *“Shkelje e rëndë/ pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë një vjeçare”*.

Arshivë-Protokolli

Gjatë vitit është mbajtur:

1. Protokollimi i dokumentacionit të Organeve të Qeverisjeve Vendore
Protokollimi i dokumentacionit nga institucionet Shtetërore dhe Private
2. Është bërë dërgimi i postës dhe hapja e saj. Nis korrespondencën për palet dhe subjektet e tjera me poste ose dorazi kundrejt firmes.
3. Çdo ditë është përgatit dosja e materialeve shkresore që i paraqiten Prefektit për shqyrtim, njoftim ose firme dhe për Sekretarin e Pergjithshëm. Veçon atë pjesë të korrespondencës që i drejtohet institucionit, si dhe atë të karakterit sekret (sipas legjislacionit përkatës), duke ia percjelle vetëm Prefektit pa i hapur.
4. Shpërndarje nëpër zyra dokumentacioni i dalë nga Prefekti dhe nga Sekretari i Pergjithshëm.

5. Shpërndarja e dokumentacionit të miratuar për Organet e Qeverisjes Vendore.
 6. Protokollimi i ankesave të shtetasve .Kontrolli i dokumentacionit për përgjigjen e ankesave të shtetasve
 7. Arkivimi i të gjithë dokumentacionit në arkivë në dosje cdo ditë.
 8. **Mbledhja e dokumentacionit që nuk është dorëzuar nga zyrat ne perfundim te afateve ligjore.**
 9. Grumbullon, sistemon, arkivon, inventarizon të gjithë dokumentacionin dhe mban pergjegjesi per ruajtjen e fondit arkivor.
 10. Ve në dispzicion te personelit dosje te caktuara ose dokumenta te veçanta te arkivuara më parë, si dhe kujdeset për kthimin e vendosjen e tyre në dosje.
 11. Siguron që në kopjen që mbahet në arkiv-protokoll, krahas elementëve të tjerë që duhet të ketë dokumenti, të jenë vendosur sigla e konceptuesit, përgjegjësit të sektorit përkatës dhe Sekretarit të Përgjithshëm.
 - 12.Sipas U.B përgatit dokumentacionin për dorëzimin e dosjeve të arshivuar, në Arshivën Qendrore (Dega Elbasan), si anëtare e komisionit
- Gjatë vitit 2023 ka pasur korespondencë për postën 1 345 letërkembime në krahasim me vitin 2023 ka pasur korespondencë për posten në 1 253, dmth 92 letër shkëmbime më tepër.
- Urdhëra të Brendshëm për vitin 2024 ka pasur 151 ndërsa për vitin 2023 ka pasur 139 urdhera në krahasim me një vit më parë ,12 urdhëra më shumë.
- Urdherat e brendshëm janë të karakteri leje te zakonshme, komisione, komisione per verifikime, urdhera emerimi, urdhera lirimi etj.
- Kanë dalur gjithësej 6 vendime për vitin 2024, ndërsa për vitin 2023 ka pasur 15 vendime pra ne krahasim me një vit më parë ka pasur 9 vendime më pak.(Vendime për emërime dhe largime nga puna).**
- Ankesa dhe ankesa nga qytetarët gjatë vitit 2024 kanë qenë 57 ndërsa për vitin 2024 kanë qenë 71, 14 ankesa më pak.

Sipas U.B është përgatitur dokumentacioni për dorëzimin e dosjeve të arshivuar, në Arshivën Qendrore (Dega Elbasan), për periudhën 2008 – 2009. Aktualisht është në përpunim dokumentacioni i vitit 2010.

Aktualisht po bëhet hartimi i dokumonetcionit tekniko profesional dhe metodologjik i shërbimit arkivor, dhe inventarizimi për listën e asgjesimit përfundimtare për vitet 1994-2009.

OBJEKTIVAT PËR VITIN 2025

1. Menaxhimin financiar eficient të fondeve të buxhetit të Institucionit, për programin e Aparatit si dhe funksionit të delegimim.
2. Parandalimin e krijimit të detyrimeve.
3. Ndjekja e të ardhurave për tu arkëtuar.
4. Monitorimi i buxhetit, dhe paraqitja e kërkesave buxhetore për ndryshim përdorim fondi, dhe shtesë fondi në zërin investime.
5. Ndjekja e procedurave të rekrutimit te punonjësve dhe deklarimi i vendeve vakante në kohë reale.
6. Përgatitja e dokumentacioni për dorëzimin e dosjeve të arshivuar, në Arshivën Qendrore (Dega Elbasan), për periudhën 2010.

PROBLEMATIKA:

1.Referuar Projekt-Buxhetit, do kërkonim të merret në konsideratë kërkesat për fonde referuar përlllogaritjeve tona, konkretisht për fondet për shpenzime operative dhe investime.

2. Referuar Projekt-Buxhetit, do kërkonim të merret në konsideratë kërkesat për fonde referuar kërkesë së përsëritur për investime;

a. për Godinën e Nënprefekturës Gramsh, pasi është teje e amortizuar dhe pjesa e tavanit, mund të pësojë shembje në çdo moment, rikonstuksioni i fundit për këtë godinë është bërë në vitin 2010, dhe me një fond minimal, në të cilën është kryer një ndërhyrje pjesërisht në pjesën e fasadës dhe tavanit.

b. për Godinën e Nënprefekturës Librazhd, pasi është teje e amortizuar dhe e ka të nevojshme për riparimi, dhe prej më shumë se 20 viteve nuk është bërë as një ndërhyrje përjashtuar, lyerjeve.

3.Gjithashtu me shkresën tonë nr.858 datë 27.07.2023 “Propozim për ndryshim strukture nga pozicioni “shofer” në pozicionin “shofer titullari”, kemi kërkuar nga Ministria e Brendshme, të refelektohet ky ndryshim.

4.Kërkesë për shtim të punonjësit të IT në strukturën e Institucionit në zbatim të VKM nr.673 datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjensisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, si detyrim ligjor për mbrojtjen e të dhenave dhe të menaxhimit të rrjetit të brendshëm kompjuterik etj.

Referuar AKSHI-it që nga data 1 Janar 2024 nuk do të ketë as një lidhje teknike me institucionet të cilët nuk kanë në strukturën e tyre një punonjës IT.

5.Të rishikohet legjislacioni, për kryerjen e shpenzimeve për pritje dhe përcjellje, përdorim nga fondi i veçantë.

6.Kërkesë për shtim të automjeteve në përdorim të Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan, konkretisht 3 automjete për Nënprefektët Librazhd, Gramsh dhe Peqin dhe një automjet për Sektorin e Emergjencave Civile, të katër këto automjete i konsiderojmë të nevojshëm me motivacioni për kryerjen e detyrave funksionale të personelit të sipër përmendur.

3. SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Veprimtaria e Sektorit të Zhvillimit Urban gjatë vitit 2024

Bazuar në Ligjin Nr.107/2016 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Urdhrin e Kryeministrit nr.50 datë 12.4.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut” dhe rregullores së brendshme të institucionit, **Objekti i punës së Sektorit të Zhvillimit Urban** është monitorimi dhe bashkërendimi i punës me organet e qeverisjes vendore dhe institucionet qendrore në nivel vendor në fushat e:

-planifikimit dhe zhvillimit dhe kontrollit të territorit sipas parimeve të ligjit “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, në nivel qarku.

- Infrastrukturës publike, urbane dhe rurale
- mbrojtjen e mjedisit dhe pastrimit të hapësirave të gjelbra publike.
- mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake
- ndjekjen e mbarëvajtjes së investimeve shtetërore.
- bujqësisë, zhvillimit rural, kullimit, ujitjes dhe kontrollit ushqimor.
- menaxhimit të burimeve ujore.

-Verifikimi i akteve të organeve të vetqeverisjes Vendore

Është bërë verifikimi i ligjshmërisë së akteve normative të këshillave bashkiakë dhe këshillit të qarkut të cilat kanë të bëjnë me çështjet që mbulon ky sektor, siç janë psh:

vendimet lidhur me linjat e transportit qytetëse dhe rrethqytetëse, vendime lidhur me problematika në fushën e mbrojtjes së mjedisit, për administrimin e fondit pyjor, për miratim kërkesash për heqje sipërfaqesh të caktuara nga fondi pyjor për shkak të ndërtimit të HEC-eve, për miratim prioritesh për investime, për shfrytëzim hapësirash publike, për dhënie me qira të pasurive shtetërore etj. Gjatë vitit 2024 nga SZHU janë marrë në shqyrtim për verifikim ligjshmërie **99 akte** të organeve të vetqeverisjes vendore (16 akte më tepër krahasuar me vitin 2023 ku kemi shqyrtuar 82 të tilla). Në çdo rast jemi shprehur për ligjshmërinë e tyre brenda afatit ligjor 10 ditor.

Problematikë gjatë verifikimit të akteve:

-Për aktet ku miratohet dhënia me qira e sipërfaqeve pyjore shpesh herë vendimi nuk shoqërohet nga relacionet përkatëse dhe harta në shkallën e kërkuar nga aktet ligjore e nënligjore. Për çdo rast i është kërkuar bashkive plotësimi i dokumentacionit dhe më pas është proceduar me konfirmimin ose jo të aktit përkatës.

-Për aktet ku miratohen linja transporti rrethqytetëse organet e njëjësive të vetqeverisjes vendore në disa raste tejkalojnë kompetencat e tyre, duke miratuar dhe linja që janë kompetencë e organeve të tjera (si psh. Këshilli i Qarkut).

-Verifikimi i ankesave dhe kërkesave të ndryshme

Është bërë trajtimi i ankesave dhe kërkesave të ndryshme të paraqitura nga qytetarë apo subjekte të ndryshme në lidhje me problematikat që mbulon sektori. Në çdo rast është ndjekur korrespondenca me institucionet kompetente dhe në raste të veçanta është bërë dhe verifikim në vend me grupe pune të ngritura me urdhër të Prefektit. Natyra e ankesave apo kërkesave të ardhura nga qytetarët, ka qenë për problematika lidhur me konflikte për ujën e pijshëm, për rrugëkalime, për shfrytëzimin e ujrave termale, për ndërtime pa leje etj. Gjatë vitit 2024 nga sektori janë shqyrtuar **27 ankesë kërkesa** (2 ankesa apo kërkesa më pak krahasuar me vitin 2023, ku kemi shqyrtuar 29 të tilla). Në çdo rast i është kthyer përgjigje ankuesit apo kërkuesit brenda afateve ligjore.

-Verifikimi i genplaneve

Në zbatim të VKM Nr.926, datë 29.12.2014 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe procedurën e shitjes”, në bashkëpunim me Degën e Shoqërive Publike gjatë kësaj periudhe është kryer vetëm 1 (një) verifikim për konfirmim genplanesh. (krahasuar me vitet e tjera: 2023 kemi kryer 12 verifikime, 2022 kemi kryer 6 verifikime).

- *Agjencia e Rezervave të Shtetit, Dorëz*”, Librazhd, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes.

-Komiteti i Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore

Mbështetur në ligjin Nr.107/2016 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, ligjin nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, si dhe VKM nr.593 datë 9.10.2018 “Për përbërjen, funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e komiteteve të menaxhimit të zonave të mbrojtura mjedisore”, gjatë vitit 2024 është zhvilluar 1 mbledhje e komitetit:

- **Më datë 02.09.2024** u zhvillua nën drejtimin e Prefektit të Qarkut takimi i Komitetit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore për Qarkun Elbasan, takim në të cilin, Drejtori i Përgjithshëm i AKZM, z.Daniel Pirushi, prezantoi procesin e nisur nga AKZM për të siguruar konformitetin me elementët teknikë dhe formalë për shpalljen e zonave të mbrojtura sipas Ligjit nr. 21/2024. Pas prezantimit, pati diskutime të shumta mbi gjendjen aktuale të Parkut Kombëtar "Shebenik", duke adresuar sfidat dhe rekomandimet për menaxhimin e qëndrueshëm të parkut.

Pjesëmarrësit nga komuniteti dhe organizata të shoqërisë civile si dhe ekspertë, ofruan komente dhe mendime të vlefshme e profesionale që do të ndihmojnë në përmirësimin e mëtejshëm të menaxhimit të parkut.

- Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin.

Bashkërendimi dhe koordinimi i punës me Agjencinë e Administrimit të Basenit Ujor Shkumbin- Seman për organizimin e mbledhjeve të këshillit të Basenit Ujëmbledhës Shkumbin, ku në bazë të ligjit nr.11/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” dhe VKM **nr.696** datë 30.10.2019 “Për përcaktimin e kufijve territorialë, hidrografikë të baseneve ujore në republikën e shqipërisë dhe të qendrës e përbërjes së këshillit të secilit prej tyre”, Prefekti është kryetar i këshillit të basenit.

Gjatë vitit 2024 Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin ka zhvilluar 5 mbledhje dhe janë marrë gjithsej **35 vendime** (*krahasuar me vitin 2023 kemi një numër të njëjtë prej 35 vendimesh*):

Në mbledhjen e datës **25.01.2024**, janë marrë **3 vendime me numër rendor 1-3**.

- **Vendim nr.1 datë 25.01.2024** “Për mosmiratimin e lejes “Për përdorim burimi ujor” me qëllim shfrytëzimin e materialeve inerte që nxirren nga shtretërit e lumenjve, përrenjve, liqeneve, me ose pa ujë, me vendndodhje: shtrati i lumit Gostimë, Bashkia Elbasan, Qarku Elbasan, subjektit “4 A-M
- **Vendim nr.2 datë 25.01.2024** “Për miratimin e kërkesës për autorizim për përdorim burimi ujor për veprimtari ndërtimore në brigje” subjektit Eni-Albania”

- Vendim nr.3 datë 25.01.2024 “Për miratimin e lejes “Përdorim burimi ujq sipërfaqësor për qëllime industriale dhe teknologjike” subjektit Eni-Albania”

Në mbledhjen e datës **11.04.2024**, janë marrë **7 vendime me numër rendor 4-10**.

- Vendim nr.4 datë 11.04.2024 “Rinovim i lejes nr. 27/2 prot. datë 4.6.2018, dhënë me vendim nr.21 datë 30.5.2018 nga KBU Shkumbin, për përdorim burimi ujq sipërfaqësor për vaditje, subjektit Albert Shopi”
- Vendim nr.5 datë 11.04.2024 “Rinovim i lejes nr. 39 prot. datë 13.7.2018, dhënë me vendim nr.27/2 datë 13.7.2018 nga KBU Shkumbin, për përdorim burimi ujq kurativ, mineral, termomineral dhe gjeotermal, subjektit Hazis Cekrezi”
- Vendim nr.6 datë 11.04.2024 “Rinovim i lejes nr. 38 prot. datë 13.7.2018, dhënë me vendim nr.26/2 datë 13.7.2018 nga KBU Shkumbin, për përdorim burimi ujq kurativ, mineral, termomineral dhe gjeotermal, subjektit Hazis Cekrezi”
- Vendim nr.7 datë 11.04.2024 “Rinovim i lejes së përdorimit të burimit ujq sipërfaqësor për prodhim hidroenergjitik me nr. Prot. 64/2 datë 16.10.2017, dhënë me vendim nr.58 datë 10.10.2017 nga KBU Shkumbin subjektit Drini Bulqizë”
- Vendim nr.8 datë 11.04.2024 “Miratim leje për përdorim burimi ujq nëntokësor për qëllime të ndryshme subjektit ANMETAL”
- Vendim nr.9 datë 11.04.2024 “Për miratimin e lejes për kryerje shpimi nëntokësor për nxjerrje uji (pus-shpim) subjektit Elona Fetahu”
- Vendim nr.10 datë 11.04.2024 “Miratim leje për përdorim burimi ujq me qëllim shfrytëzimin e materialeve inerte që nxirren nga shtretërit e lumenjve, përrenjve, liqeneve, me ose pa ujë me vendndodhje: shtrati i lumit Gostimë, Bashkia Elbasan, Qarku Elbasan, subjektit “4 A-M”

Për vendimet e mësipërme janë zbardhur dhe lejet përkatëse sipas formatit.

Në mbledhjen e datës **30.07.2024**, janë marrë **4 vendime me numër rendor 11-14**.

- Vendim nr.11 datë 30.07.2024 “Për miratimin e lejes për përdorim burimi ujq nëntokësor për qëllime të ndryshme, subjektit Frutibest ”
- Vendim nr.12 datë 30.07.2024 “Për miratimin e lejes për përdorim burimi ujq nëntokësor për qëllime të ndryshme, subjektit Klodian Balla”
- Vendim nr.13 datë 30.07.2024 “Për miratimin e lejes për përdorim burimi ujq nëntokësor për qëllime industriale, subjektit Enira-Metal”
- Vendim nr.14 datë 30.07.2024 “Për miratimin e lejes për përdorim burimi ujq sipërfaqësor për qëllime industriale dhe teknologjike, subjektit Eni-Albania”

Për vendimet e mësipërme janë zbardhur dhe lejet përkatëse sipas formatit

Në mbledhjen e datës **19.09.2024**, janë marrë **6 vendime me numër rendor 15-20**.

- Vendim nr.15 datë 19.09.2024 “Për miratimin e lejes për përdorim burimi ujq kurativ, mineral, termomineral dhe gjeotermal, subjektit Boçi 2020”

- Vendim nr.16 datë 19.09.2024 “Për miratim të kërkesës për transferim të lejes, nga shoqëria L.N.K. Sh.P.K. tek shoqëria Anta En 2015 Sh.P.K.”
- Vendim nr.17 datë 19.09.2024 “Për miratimin e lejes për përdorim burimi ujqor kurativ, mineral, termomineral dhe gjeotermal, subjektit Arben Ismailaj”
- Vendim nr.18 datë 19.09.2024 “Për miratimin e kërkesës për autorizim për përdorim burimi ujqor për veprimtari në brigje, subjektit Eni-Albania ”
- Vendim nr.19 datë 19.09.2024 “Për saktësimin e koordinatave dhe rinovimin e lejes nr.48 prot. datë 23.07.2018, dhënë nga KBU Shkumbin Për përdorim burimi nëntokësor për qëllime industriale, subjektit Alb Tech Plast”
- Vendim nr.20 datë 19.09.2024 “Për miratimin e lejes për përdorim burimi ujqor sipërfaqësor për akuakulturë, subjektit Albert Hoxha Sh.P.K.”

Për vendimet e mësipërme janë zbardhur dhe lejet përkatëse sipas formatit

Në mbledhjen e datës **19.12.2024** janë marrë **15 vendime me numër rendor 21-35.**

- Vendim nr.21 datë 19.12.2024 “Për miratimin e lejes për përdorim burimi ujqor nëntokësor për qëllime industriale, subjektit Serinçay”
- Vendim nr.22 datë 19.12.2024 “Për miratimin e lejes për kryerje shpimi nëntokësor për nxjerrje uji (pus-shpim) subjektit Renato Skënderi”
- Vendim nr.23 datë 19.12.2024 “Për miratimin e lejes për përdorim të burimit ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjitik, subjektit Juana Sh.P.K.”
- Vendim nr.24 datë 19.12.2024 “Për miratimin e lejes për përdorim burimi ujqor me qëllim shfrytëzimin e materialeve inerte që nxirren nga shtretërit e lumenjve, përrenjve, liqeneve, me ose pa ujë me vendndodhje: shtrati i lumit Shkumbin, Qarku Elbasan, subjektit “A N K”
- Vendim nr.25 datë 19.12.2024 “Për miratim të kërkesës për transferim të lejes, nga subjekti Sh.A.Ujësjiellës Kanalizime Peqin tek shoqëria rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan”
- Vendim nr.26 datë 19.12.2024 “Për miratim të kërkesës për transferim të lejes, nga subjekti Sh.A.Ujësjiellës Kanalizime Librazhd tek shoqëria rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan”
- Vendim nr.27 datë 19.12.2024 “Për miratim të kërkesës për transferim të lejes, nga subjekti Sh.A.Ujësjiellës Kanalizime Fshat Elbasan tek shoqëria rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan”
- Vendim nr.28 datë 19.12.2024 “Për miratim të kërkesës për transferim të lejes, nga subjekti Sh.A.Ujësjiellës Kanalizime Fshat Elbasan tek shoqëria rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan”
- Vendim nr.29 datë 19.12.2024 “Për miratimin e lejes për nxjerrje dhe shfrytëzim të ujit nëntokësor nëpërmjet shpimit, për qëllime të ndryshme, subjektit Gentiana Tafa”

- Vendim nr.30 datë 19.12.2024 “Për rinovimin e lejes me nr.45 prot. datë 23.7.2018, dhënë me vendim nr.33/2 datë 13.07.2018 Për përdorim burimi uJOR nëntokësor për qëllime industriale subjektit GSA Sh.P.K”
- Vendim nr.31 datë 19.12.2024 “Për miratimin e lejes për përdorim burimi uJOR kurativ, mineral, termomineral dhe gjeotermal, subjektit Hysen Miza ”
- Vendim nr.32 datë 19.12.2024 “Për autorizimin nr.serial 000219 subjektit Bashkia Librazhd
- Vendim nr.33 datë 19.12.2024 “Për miratim të kërkesës për transferim të lejes, nga shoqëria C&S Construction Sh.P.K. tek shoqëria C&S Energy Sh.P.K”
- Vendim nr.34 datë 19.12.2024 “Për miratimin e lejes për përdorim burimi uJOR sipërfaqësor për prodhim hidroenergjitik, HEC Gizavesh, të shoqërisë Dardania Green Energy Sh.P.K., në zbatim të vendimit nr.2639 datë 10.07.2024 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”
- Vendim nr.35 datë 19.12.2024 “Për miratimin e kërkesë për leje për përdorim burimi uJOR nëntokësor për ujë të ambalazhuar, subjektit Shebenik Ëater”

Për vendimet e mësipërme janë zbardhur dhe lejet përkatëse sipas formatit

- **Koordinimi me njësitë e vetqeverisjes vendore në kuadër të task-forcës për përdorimin e qeseve plastike**

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.35 datë 19.02.2024 “Për përbërjen, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Task-Forcës për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike të Oxo-Degradueshme dhe Oxo-Biodegradueshme”, kemi bashkëpunuar me Task- Forcën qendrore për të patur një koordinim sa më të mirë me organet e vetqeverisjes vendore gjatë ushtrimit të kontroleve. Më datë 28.03.2024, nëpërmjet postës elektronike, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit na është kërkuar koordinimi me bashkitë për adresat e tregjeve agro-ushqimore që operojnë në territorin e bashkive të qarkut. Më datë 16.04.2024 i kemi kthyer përgjigje Agjencisë Kombëtare të Mjedisit lidhur me çfarë ka kërkuar.

Po në zbatim të urdhrit të Kryeministrit të sipërcituar, më datë 21.06.2024, pranë Insitucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan është zhvilluar një takim i kërkuar nga përfaqësuesit e Task- Forcës, ku morën pjesë përfaqësuesit e Task Forcës, përfaqësues të institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan dhe përfaqësues të bashkive të qarkut, të cilët janë të angazhuar në terren për kontrollin e mospërdorimit të qeseve të jashtëligjshme. Qëllimi i takimit ishte koordinimi më i mirë i punës në lidhje me organizimin e kontroleve në pikat e tregjeve agro-ushqimore, operatorëve ekonomikë etj., në fushën e prodhimit, si dhe trajnimin e personave përgjegjës për identifikimin e qeseve jashtë standardit që përcaktohet në ligj.

Po në kuadër të Task- Forcës me shkresën tonë nr.405/3 prot. datë 06.12.2024, në prag të festave të fund vitit, i kemi kërkuar bashkive të qarkut bashkëpunimin për monitorimin e tregjeve për kontrollimin e mospërdorimit të qeseve plastike të jashtëligjshme. Situata ka patur përmirësim por gjithsesi ende vërehet përdorimi i qeseve të jashtëligjshme sidomos nga tregtarët ambulante.

- Marrëdhëniet me degët territoriale që veprojnë në qark

Marrëdhëniet me degët territoriale kanë qenë të mira duke bashkëpunuar dhe bashkërenduar punën në zbatim të politikave të qeverisë. Këto të fundit kanë informuar periodikisht institucionin e Prefektit me raportime mujore, 6-mujore dhe vjetore lidhur me veprimtarinë e tyre. Pranë sektorit tonë raportojnë institucionet e mëposhtme:

Agjencia Rajonale e Mjedisit

Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor

Dr.Raj. e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit

IKMT Dr.Raj.Elbasan

Dr.Raj.e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve

ASHK Drejtoria Vendore Elbasan

Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura, Elbasan

Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Korçë, Seksioni Elbasan

Zyra e Ad.të Basenit Ujor Shkumbin Seman Fier

Zyrat përkatëse nëpër bashki që mbulojnë këto fusha.

SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Anesti Kapurani (Përgjegjës Sektori)

Iris Çerekja (Specialiste)

4. SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Gjatë vitit 2024 kemi pasur situata emergjente:

Gjatë muajve Janar dhe Shkurt 2024, kemi pasur ngjarje si pasojë e fenomeneve natyrore:

- Temperatura të ulëta, dëborë dhe ngrica që sollën bllokim të rrugëve kryesisht rurale në disa prej bashkive të qarkut si Elbasan, Librazhd e Prrenjas.
- Ndërprerje dhe mungesë të furnizimit me energji elektrike në bashkitë Librazhd, Gramsh, si dhe Elbasan e Cërrik.
- Rënie gurësh dhe inertesh në rrugë, akset: Elbasan-Librazhd, Elbasan-Peqin, Cërrik-Gramsh, Gramsh-Moglicë.
- Shfaqjen e rreth 101 vatra zjarri në pyje e kullota ku më problematiku zjarri që përfshiu 2 bashkitë Belsh dhe Peqin, në Nj.A Rrasë dhe Nj.A Gjocaj, ku u dogjën rreth 40 ha pyje e bimësi e ulët. Janë angazhuar për normalizimin e situatës 1199 forca zjarrëfikëse e 298 mjete të MZSH.

Në muajt Janar, Shkurt 2024 qarku Elbasan u përfshi nga mot me temperatura të ulëta (rrallë herë nën zero gradë celcius), reshje shiu me intensitet të lartë, reshje dëbore dhe ngrica në rrugë. Në disa segmente si: Fushë Studë-Stëblevë, segmenti Qafë Thanë, dhe akse rrugore që kalojnë në lartësi apo që lidhin fshatrat e njësisive si Labinot Mal, Funar në bashkinë Elbasan, Njësia Stëblevë në bashkinë Librazhd, Rrajcë në bashkinë Prrenjas dhe Lenie e Poroçan në bashkinë Gramsh trashësia e dëborës arriti deri 30-40cm. Ndërkohë që në periudhën Gusht-Shtator, kemi pasur prani zjarresh në pyje e kullota ku disa prej tyre kanë zgjatur disa ditë dhe kanë djegur sipërfaqe deri dhjetëra hektarë.


Nga krahasimi me fenomenet natyrore, ngjarjet dhe situatat emergjente të vitit paraardhës, viti 2024 ka pasur më pak raste të tilla (ditë me ngrica, shi me intensitet të lartë, përmytje, bllokim rruge, rrëshqijte etj).

Vatrat e zjarrit të vitit 2024 janë 101 (55 vatra më shumë se viti 2023) ndërkohë janë angazhuar 1199 (600 më shumë forca zjarrëfikëse) dhe 298 (142 mjete më shumë).

DISA NGA NGJARJET DHE SITUATAT EMERGJENTE NË TË CILAT SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE U ANGAZHUA NË BASHKËPUNIMIN NDËRINSTITUCIONAL.

Nisur nga specifikat e ngjarjeve dhe risku i lartë është vlerësuar me prioritet dhe është mundësuar:

Në bashkëpunim me Ministrisë së Mbrojtjes, forcat Detashmenti Rajonal i Mbrojtjes u zhvilluan operacione për fikjen e zjarreve që zgjatën disa ditë, ishin në terrene të vështira dhe përhapje të gjerë:



- Nj.A Qukës në rezervatin natyror Rrajcë-Xhyrë, bashkia Prrrenjas (15 Korrik 3 ha pyje ahu, dushku)
- Nj.A Zavalinë në malin e Bukonikut, bashkia Elbasan (28 Korrik 5 ha pyje ahu të djegur)

Nj.A Papër, në fshatin Valas bashkia Elbasan (5 Gusht 50 ha të djegura dhe 5 mijë rrënjë kryesisht arrorë) . Këtu U angazhuan forca dhe mjete të disa bashkive të qarkut Elbasan.

Gjithashtu po rendisim edhe disa nga ngjarjet dhe situatat emergjente gjatë vitit 2024:

Në 13 Maj 2 turistë u bllokuan në kanionet e Holtës të bashkisë Gramsh në pamundësi për të lëvizur në një pozicion 100m thellësi. Ndhimohen nga forcat zjarrfikëse, operacion i zhvilluar me sukses.

Në 1 Prill dhe 30 Korrik 2 vatra zjarri në Nj.A Labinot Mal kun ë rastin e dytë vatra e zjarrit kaloi në fshatin Godolesh të bashkisë Elbasan, ku u dogjën 2 ha dhe 400 rrënjë qershi.

Në 2 Prill, 4 Gusht e 11 Gusht vatra zjarri respektivisht në Nj.A Stravaj, në parkun Kombëtar Shebenik-Jabllanicë dhe Nj.A Rrajcë ku u dogjën rreth 9 ha pyje e 2 banesa të braktisura.

Në 14 Gusht në Nj.A Fierzë kemi patur një vatërr zjarri me përhpage dhe sipërfaqe të madhe të djegur, zjarr me pikënisje në bashkinë Lushnjë ku u dogjën rreth 20 ha dhe 4000 rrënjë drufrutorë dhe 1 ha vreshta. U angazhuan forca dhe mjete të Prefekturës Elbasan dhe Berat, u arrit të mbrohen rreth 40 banesa të fshatit Fierzë ku në disa moment zjarri arriti pak metra larg banesave

Në datën 15 Gusht patëm një vatër zjarri në bashkinë Cërrik në vendin e quajtur radiostacioni ku u dogjën 50 shkurre duke eliminuar rrezikun në banesa. U angazhuan forca dhe mjete të disa bashkive të qarkut Elbasan.

Në datën 4 Shtator patëm një vatër zjarri në repartin e riciklimit dhe prodhimit të materialeve plastikë. U angazhuan forca dhe mjete të Prefekturës Elbasan, ku u dogjën 2000m² panele diellorë dhe 5000 arka plastike.

Në 22 Nentor bllokim rruge në disa pjesë në aksin rrugor nacional Elbasan-Qafë Thanë në segmentin Librazhd-Prrenjas, Librazhd Elbasan për shkak të shirave të fortë ku për 30 min ranë 28mm shi.

Janë zhvilluar 4 mbledhje të Komisionit të Mbrojtjes Civile për marrje masash paraprake ose për raste emergjencash, në zbatim të Ligjit Nr.45/2019 “Për mbrojtjen Civile”, 2 më pak se viti i kaluar. (Kjo pasi kemi pasur më pak faktorë dhe situata emergjente)

Janë shqyrtuar dhe konfirmuar **30** (47 për vitin 2023) vendime të këshillave bashkiakë, për ngjarje të cilat janë objekt i ligjit Nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”. Janë kthyer **4** (1 për vitin 2023) vendime të këshillave bashkiakë dhe **2** (17 për vitin 2023) vendime i janë ridërguar këshillave bashkiakë për zbatim të ligjshmërisë së aktit. Referuar vitit 2023, kemi miratuar 17 vendime të këshillave bashkiakë më pak, janë kthyer 3 vendime të këshillave bashkiakë më shumë dhe i janë ridërguar këshillave bashkiakë për zbatim të ligjshmërisë 15 vendime më pak.

Janë shqyrtuar dhe janë dërguar në Agjensinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile Tiranë **2** (5 për vitin 2023) dosje me dokumentacionin përkatës tekniko-ligjor për tu kompensuar për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, pra 3 dosje më pak se në vitin 2023.

Është bashkëpunuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave të Materialeve të Shtetit Tiranë me **11** (12 për vitin 2023) kërkesa dhe janë ndihmuar familjet që kanë pësuar fatkeqësi natyrore në banesa me çadra, krevatë, dyshekë, batanije, paisje elektroshtëpiake, ushqime e veshmbathje dhe bazë ushqimore për bagëtitë, 1 kërkesa më pak se viti 2023.

Është kërkuar ndihmë institucionale dhe është realizuar bashkëpunimi me Agjensinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe me specialistë nga forcat e Ministrisë së Mbrojtjes për **17** (11 për vitin 2023) raste të municioneve të ndryshme të gjetura në territorin e qarkut tonë, 6 raste më shumë se në vitin 2023. Ndërkohë që forca të ushtrisë nga Ministria e Mbrojtjes janë angazhuar dhe kanë mbështetur forcat dhe mjetet e MZSH së qarkut për vatrën e zjarrit të rënë në vendgrumbullimin e mbetjeve tek inceneratori Elbasan, dhe për vatrën e zjarrit të rënë në vendgrumbullimin e skrapit në ambientet e subjektit privat “Kurum International”.sha në territorin e ish Kombinatit Metalurgjik si dhe për vatrën e zjarrit të rënë në malin Bukanik, Nj.A Zavalinë.

Kemi pasur bashkëpunim me Institutin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar në **3** (2 për vitin 2023 raste), 1 rast më shumë se në vitin 2023, duke kërkuar mbështetje për pregtitjen e studimit gjeologjik për zona të caktuara të kërkuara nga bashkitë përkatëse.

Kemi pasur bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Ujitjes e Kullimit Korçë në **3** (4 për vitin 2023) raste për ndërhyrje me specialistë e mjete, 1 rast më pak se viti 2023.

Janë trajtuar dhe shqyrtuar edhe **45** dokumenta dhe materiale të ndryshme si: (Kërkesa për informacion, në vëmendjen e bashkive, për zbatim bashkive, njoftime të ndryshme, kthim përgjigje për probleme të ndryshme etj.)

MASAT PARANDALUESE PËR EMERGJENCAT CIVILE

Drejtoria Rajonale e Ujitjes e Kullimit Korë

Argjinatura e lumit Shkumbin (Bashkia Elbasan)

- Ka përfunduar investimi “Mbrojtja nga lumi Shkumbin në Jagodinë Nj.A Shirgjan”, Elbasan
Gjatësi: 500m linearë Vlera: **82,500,000 lekë**

Argjinatura e lumit Devoll (Bashkia Cërrik)

- Ka përfunduar investimi (Loti 8) “Mbrojtja nga gërryerja, krahu i majtë i lumit Devoll në segmentin Mollas-Dasar”.
Gjatësi: 2100 m linearë Vlera: **162,000,000 lekë**

Bashkia Elbasan

- Riparim i argjinaturës mbrojtëse të përroit Zaranikë
7.335.071 lekë
- Ndërtimi i urës që lidh rrugën lokale Papri me rrugën Xhikzonja në fshatin Bujaras Nj.A Gjergjan **8.013.135 lekë**
- Ura mbi përroin e Llixhës, në Jagodinë Nj.A Shirgjan + ura mbi përroin “Balta e Gaxhjes” fshati Shushicë Nj.A Shushicë
2.376.568 lekë
- Ura mbi përroin Gorre(degëzim i përroit të Paprit) në Papër Sollak Nj.A Papër
4.236.716 lekë
- Ndërtim muri pritës në lagjen 5 Maj për mbrojtjen e banesave nga rrëshqitja
1.597.826 lekë
- **Nga fondi i Emergjencave Civile të bashkisë**
- Ndërtimi i murit mbrojtës të varrezave në Labinot Katund Nj.A Labinot Mal
2.033.882 lekë
- Ndërtim muri mbajtës dhe sistemim i përroit Gjonme Nj.A Gjergjan
1.464.215 lekë

Bashkia Cërrrik

- Është në zbatim projekti “Mbrotjtja nga gërryerja dhe përmytja e fshatit Selitë” (nga fondi i M.M për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore).
15,484,779 lekë

Bashkia Gramsh

- Nuk ka investime

Bashkia Prrenjas

- Rikonstruksion i kanalit të ujërave të larta faza e parë i cili mbron zonën urbane të Prrenjasit nga përmytja (nga fondi i kushtëzuar)
2.791.592 lekë
- Pastrimi i kanaleve të dyta e të treta në Kododesh-Urakë, dhe Rrajcë Fushë-Prrenjas Fshat. Parandalon përmytjet në fushë gropën e Prrenjasit dhe gjithë bashkinë.
2.000.000 lekë

Bashkia Belsh

- Nuk ka investime
- **Bashkia Peqin**
- Është në zbatim investimi për rehabilitimin e kanalit kullues në fshatin Rrumbullak
4.000.000 lekë

Bashkia Librazhd

- Kryerje punimesh në pritën lumore të lumit Gostimë
1.898.474 lekë

Nga Autoriteti Rrugor Shqiptar

- Vazhdon investimi i ARRSH për aksin rrugor nacional pjesë e koridorit të tetë.
- Asfaltimi i segmentit Zgosht-Borovë pjesë e aksit rrugor Librazhd-Ura Cerencit.
- Në aksin rrugor nacional Elbasan-Rrogzhinë në kryqëzimin e Gjocajt është mundësuar zgjerimi i hyrje daljeve për mjetet që vijnë nga Nj.A Gjocaj dhe nga bashkia Peqin për të vazhduar lëvizjen në këtë aks rrugor.

Nga Institucionet Vendore të cilat midis të tjerave kanë objekt të punës së tyre edhe luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike, rezultojnë:

- 20500 kontrole të kryera nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, drejtoritë dhe strukturat e tjera rajonale.
- Janë asgjësuar 274 bimë narkotike dhe 890 fidanë në kubikë.
- Gjithsej gjatë kontrolleve të territorit dhe me informacion policor gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2024 janë konstatuar gjithsej 6 raste:
- Janë evidentuar 6 raste dhe janë zbuluar 6 raste
- Të impikuar 14 shtetas, të arrestuar 8, ndaluar 2, në gjendje të lirë 1 në kërkim 3.

5. SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE DHE FUNKSIONEVE TË DELEGUARA

1. Struktura

Sektori Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara i Institucionit të Prefekti të Qarkut Elbasan, në bazë të urdhrit nr.5 datë 12.01.2016 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së administratës së Prefektit”, përbëhet nga: 1 Përgjegjës Sektori dhe 5 Specialist, përkatësisht:

Përgjegjës Sektori	vakant
• Specialist Shërbimesh	vakant
• Specialist për Çështjet Vendore	Jona Ciro
• Specialist për Turizmin dhe Funksioneve të Deleguara	Anxhela Mukja
• Specialist Përpunim të Dhënash dhe Statistikash	Sidorela Grembi
• Specialist për Sigurinë Publike dhe Shërbimin Zjarrfikës	Bledar Gjini

2. Detyrat e Sektorit

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, të Rregullores së Brendshme të miratuar me urdhrin nr.67 datë 29.07.2020 “Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Institucionit të Prefekti të Qarkut Elbasan”, sektori ka këto detyra:

1. Monitoron ecurinë e zbatimit të politikave të përgjithshme zhvillimore të territorit, përputhshmërinë e tyre me legjislacionin në fuqi, drejtimin strategjik dhe kontekstin territorial
2. Koordinon punën me institucionet qendrore në nivel qarku për konsultimet me njësitë e vetëqeverisjes vendore për politikën, legjislacionin dhe normat që rregullojnë dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave e të funksioneve të këtyre njësive, si dhe konsultimin, nëpërmjet shoqatave

përfaqësuese të vetëqeverisjes vendore dhe grupeve të tjera interesit, nëpërmjet të cilit u mundësohet prezantimi i opinioneve, komenteve dhe propozimeve të tyre për politikën dhe legjislacionin që ka ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të tyre, sipas përcaktimit me vendim të Këshillit të Ministrave

3. Monitoron dhe asiston në mënyrë të vazhdueshme organet e njësive të vetëqeverisjes vendore dhe sipas nevojës, procedurat për shpërndarjen apo shkarkimin e këtyre organeve.
4. Evidenton problemet për të cilat janë të interesuara organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, në raport me organet dhe institucionet shtetërore qendrore në nivel vendor, dhe përpunon të dhënat për këto probleme.
5. Ndjek procedurën e hartimit të projektbuxhetit dhe të miratimit të zbatimit të buxhetit të organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore
6. Shqyrton kapacitetin fiskal vendor për çdo bashki dhe këshillin e qarkut, si dhe ndjek në mënyrë periodike realizimin e të ardhurave nga taksat vendore sipas llojeve të taksave.
7. Përgatit informacione lidhur me vendimet e organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore në fushën e kompetencave vendore dhe funksioneve të deleguara në nivel vendor, në kuadër të verifikimit të ligjshmërisë së aktit normativ.
8. Në bashkëpunim me sektorin përkatës në ministrinë përgjegjëse për veprimtarinë e prefektit realizon koordinimin dhe udhëheqjen metodologjike të sistemit fiskal vendor.
9. Bashkërendon punën ndërmjet institucioneve qendrore dhe organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe përgjigjet për hartimin e programeve të zhvillimit në nivel qarku.
10. Bashkërendon punën me strukturat përkatëse për mbarëvajtjen e sezonit turistik, si dhe turizmin në përgjithësi gjatë vitit.
11. Përgatit materialet përkatëse për Task-Forcat e prefektit e qarkut dhe ndjek zbatimin e detyrave të përcaktuara lidhur me kompetencave vendore dhe funksionet e deleguara.
12. Ndjek sipas rastit zbatimin e detyrave të përcaktuara nga Task-Forca të veçanta për sezonin turistik.
13. Ndjek problemet e sigurisë në plazhe e zona të tjera turistike, higjienën, problemet shëndetësore, emergjencat civile, qarkullimin rrugor etj.

14. Harton materiale informative-statistikore për gjendjen ekonomiko-shoqërore në qark dhe mbi bazën e tyre, i propozon prefektit të qarkut mendim për përmirësimin e gjendjes.
15. Koordinon punën me institucionet qendrore në nivel qarku për konsultimet me njësitë e vetëqeverisjes vendore për politikën, legjislacionin dhe normat që rregullojnë dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave e të funksioneve të këtyre njësive, si dhe konsultimin, nëpërmjet shoqatave përfaqësuese të vetëqeverisjes vendore dhe grupeve të tjera interesit, nëpërmjet të cilit u mundësohet prezantimi i opinioneve, komenteve dhe propozimeve të tyre për politikën dhe legjislacionin që ka ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të tyre, sipas përcaktimit me vendim të Këshillit të Ministrave.
16. Bashkërendon dhe merr masa për garantimin e pjesëmarrjes publike në procesin e vendimmarrjes të vetëqeverisjes vendore, si dhe për njoftimin e konsultimitin publik, me qëllim këshillimin me bashkësinë përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve, të cilat janë të detyrueshme.
17. Bashkërendon punën me strukturat përkatëse për realizimin e funksioneve në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, në fushën e shërbimeve sociale, në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese, në fushën e mbrojtjes së mjedisit, në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit në fushën e zhvillimit ekonomik vendor, në fushën e sigurisë publike, si dhe për funksionet dhe kompetencat e deleguara.
18. Drejton, monitoron dhe ndjek detyrat e përcaktuara në Task-Forcat dhe organizma të përkohshëm, që kanë të bëjnë me funksione të deleguara.

AKTIVITETI I SEKTORIT GJATË VITIT 2024

1. REGJISTRIMI I FËMIJËVE NË KLASË TË PARË 2024-2025

Në zbatim të Urdhërit të përbashkët ndërmjet, Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Nr.292,dt.28.05.2019, Për miratimin e rregullores për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet tri ministrive, “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor”, si dhe në zbatim të ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i cili ka si rol kryesor

organizimin dhe monitorimin e këtij procesi, Sektori i Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara ka ndjekur këtë proces me përgjegjshmëri duke organizuar mbledhje dhe duke u informuar pas mbylljes së çdo faze për numrin e nxënësve të regjistruar deri në përfundimin e identifikimit të të gjithë nxënësve që kanë arritur moshën e detyrimit shkollor në të gjithë qarkun e Elbasanit.

Është realizuar më datë 06.09.2024 mbledhja, “Mbi procesin e identifikimit dhe regjistrimit të fëmijëve në klasat e para si dhe paketën e sigurisë në shkolla për vitin shkollor 2024-2025”, si dhe janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar Elbasan, duke monitoruar kështu çdo fazë të regjistrimit të fëmijëve në klasat e para, nga të cilat rezultojnë se procesi i regjistrimit ka vijuar normalisht dhe pa problematika. Më poshtë janë shprehur shifrat në lidhje me numrin e fëmijëve të regjistruar në klasat e para për vitin shkollor 2024-2025 nga ku rezultojnë se në të gjithë ZVAP –të e Qarkut Elbasan janë ulur në bankat e shkollës për herë të parë **2173 nxënës**.

Tabela Përmbledhëse krahasuese mbi regjistrimin e fëmijëve në klasat e para për vitin shkollor 2023-2024 dhe 2024-2025

QARKU ELBASAN	Nr. i nxënësve të regjistruar viti 2023-2024	Nr. i nxënësve të regjistruar Viti 2024- 2025
ZVA. ELBASAN	1306	1187
ZVA. LIBRAZHD	294	214
ZVA. PRRENJAS	209	194
ZVA. GRAMSH	174	145
ZVA. CËRRIK	198	179
ZVA. BELSH	112	107
ZVA. PEQIN	196	147
TOTALI	2489	2173

Nga ZVAP Elbasan u raportua paraprakisht se nuk ishin regjistruar 4 fëmijë të cilët kanë mbushur moshën e detyrimit shkollor për regjistrim në klasën e parë, pas koordinimit dhe verifikimit të kryer nga Komisariati i Policisë Elbasan rezulton se një prej fëmijëve ka problem në të folur, dy prej fëmijëve janë larguar jashtë shtetit, përkatësisht Belgjikë dhe Itali, ndërsa fëmija i katërt është regjistruar në shkollën private “Green School”. Në ZVAP Gramsh nuk janë regjistruar 6 fëmijë në klasat e para, sipas verifikimit të kryer nga Komisariati i Policisë Gramsh prindërit kanë zgjedhur të mos i regjistrojnë për arsye të mos mbushjes së moshës, si dhe për arsye shëndetësore.

Krahasuar me vitin shkollor 2023-2024, për vitin shkollor 2024-2025 janë regjistruar **316 fëmijë** më pak, shkak është ulja e lindshmërisë, emigrimi dhe shpërngulja familjare jashtë vendit.

2. PAKETA E SIGURISË NË SHKOLLA

Në zbatim të ligjit Nr. 107 dt.27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut" në mbështetje të shkresës së Ministrit të Brendshme me Nr. Prot.9298 mbi "Paketën e Sigurisë në Shkolla", u monitorua ecuria dhe u evidentuan problematikat të cilat u hasën përgjatë zbatimit të paketës së sigurisë në shkolla.

Në datë 19.01.2024 u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan, mbledhja mbi mbarëvajtjen dhe problematikat e hasura në mbarëvajtjen e Paketës së Sigurisë në Shkolla për vitin 2024-2025. Përsa i përket ecurisë së përmbyshjes së Paketës së Sigurisë në Shkolla për vitin 2024-2025, informacioni vijon si më poshtë:

PAKETA E SIGURISË NË SHKOLLA ZVAP-TË E QARKUT ELBASAN

ZVAP Elbasan

Përmirësimi i sigurisë faktike dhe të përceptuar në ambjentet e shkollave dhe ambjentet përreth, nëpërmjet krijimit të figurës së oficerit të sigurisë në institucionet e arsimit parauniversitar.

Në institucionet e ZVAP janë 11 Oficerë Sigurie (2 me raport leje lindjeje) të cilët ushtrojnë funksionin e tyre në kryesisht në gjimnazet e zonës urbane : “Mahir Domi”, “Dhaskal Todri”, “Anastas Çakalli”, “Naim Frashëri”, “Vasil Kamami”, “Luigj Gurakuqi”, “Konstandin Kristoforidhi”, “Ahmet Dakli” dhe “GJKP“, “Mahir Domi”. Që në momentin e dislokimit të Oficerëve të Sigurisë në shkolla janë marrë masat që siguria në hyrje dhe në dalje e nxënësve të jetë në nivele të larta. Oficerët e Sigurisë janë certifikuar nga Akademia e Sigurisë në kursin “Oficer i sigurisë në shkolla“ dhe “Oficerët e sigurisë në shkollat publike“ dhe kanë marrë trajnime në vazhdim për fushata ndërgjegjësimi në shkolla.

Garantimi i një mjedisi të sigurt për nxënësit brenda dhe jashtë shkolle si edhe në territorin përreth saj.

Garantimi i një mjedisi të sigurt për nxënësit ka qenë në qendër të vëmendjes , kjo ka nisur që në fillim të çdo vitit të ri shkollor. ZVAP Elbasan , në bashkëpunim me Bashkinë Elbasan ka bërë të mundur garantimin e kushteve fizike të godinave të institucioneve, por ende ka nevojë për përmirësimin e këtyre mjediseve, në disa shkolla vartëse mungon muri rrethues (Bujaras, Kodra Bujaras, Dërstilan). Bashkëpunimi me Policinë e Shtetit është forcuar nëpërmjet kontakteve të rregullta me oficerin përgjegjës të NJA.

Komisionet e Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit në Institucionet Arsimore të ngritura në bazë të të urdhërit nr.31, datë 28.01.2020 për ‘‘Miratimin e Rregullores për funksionimin e institucioneve parauniversitare në Republikën e Shqipërisë’’ i ndryshuar, kanë mbikqyrur rregullisht kushtet e ruajtjes së shëndetit, higjenës , pastërtisë, mjedisit dhe të sigurisë së nxënësve dhe janë marrë masat për përmirësimin e tyre .

Perimetri i sigurisë

Bazuar në detyrimet që rrjedhin për zbatimin e Paketës së Sigurisë në shkolla, pas verifikimit në terren, në IA e ZVAP-së sonë hapsirat fizike brenda dhe jashtë institucionit ofrojnë siguri për nxënësit e tyre. Shkolla **‘‘Bardhyl Popa’’** raporton si **problem rrugicën që lidh dy rrugët ‘‘Pusi që lahet vet’’ me rrugën ‘‘Janaq Kilica’’**, pasi është e pakontrolluar nga kamerat dhe shpesh shërben për veprime të rrezikshme të nxënësve. Drejtoria e shkollës e sheh të domosdoshme monitorimin të kësaj rrugice nga policia në oraret e daljeve të nxënësve (12:00-13:30). **Shkollat ‘‘Ptoleme Xhuvani’’ dhe ‘‘Mahir Domi’’** ngrenë si shqetësim parkimin e makinave para portës dalëse të tyre gjë që e bën të rrezikshme daljen e nxënësve në raste emergjente (termet, zjarri). Në godinën e shkollës **‘‘Vasil Kamami’’** sistemi elektrik është i amortizuar dhe herë pas herë ka shfaqur difekte në rrjet.

Sinjalistika rrugore

Gjatë orareve të lëvizjeve të nxënësve (mëngjes e drekë) Policia Bashkiake monitoron lëvizjet e mjeteve dhe këmbësorëve pranë çdo shkolle ku është e nevojshme. Shqetësime dhe kërkesa të përsëritura për **mungesën e sinjalistikës kanë ardhur nga shkolla ‘‘Alush Lleshanaku’’**. Një problem sensitiv që cënon sigurinë e jetës së nxënësve të shkollës **‘‘Europa’’** dhe mjaft shqetësues për komunitetin e zonës, prindërit dhe stafin pedagogjik është mungesa e semaforit në segmentin dalës nga autostrada dhe i sinjalistikës rrugore përreth saj. Shkolla ndodhet në mes të autostradës nacionale Elbasan-Tiranë, rruga ka një ndërprerje, nevojitet marrja e masave të menjëhershme për të rritur sigurinë rrugore përreth shkollës dhe mirëqenien fizike të nxënësve dhe komunitetit.

Kamerat e sigurisë

Vazhdon të mbetet shqetësim funksionimi i jo i plotë i tyre. Në shkollat Shilbater "Ibrahim Çeka", "Isuf Deliu" Mollagjesh, Lleshan e Papër kemi mosfunksionim të kamerave si edhe një kamerë në shkollën vartëse të saj Broshkë. Funksionim pjesshëm të kamerave ka në shkollat: "Alush Lleshanaku", "Isuf Deliu" Mollagjesh, "Sali N.Ballkoçi", "Sulejman Rranci", "Ramë Karagjozi", "Dalip Qoku", "Budan", "Themistokli Kaçi" dhe "Banush Llapushi", Pashtresh, Valësh, Dërstilë, Kozan e Mamël. Shkolla në Muriqan vartëse e shkollës "Ali Sollaku" kamerat janë jashtë funksionit për efekt të sistemit të amortizuar elektrik, ndërsa shkollat vartëse Plangaricë e Tërbaç Mlizë dhe Çikallesh nuk janë pajisur me kamera.

Fikëset e zjarrit

Drejtuesit e IA-ve janë kujdesur që fikset e zjarrit të jenë funksionale por ka ende shkolla që i kanë jashtë funksionit.

Ide, për përfshirjen e projektit i "Smart City" në ruajtjen e perimetrit të sigurisë në shkolla.

Shkolla "Jeronim De Rada" ka qenë pjesë e projekteve të kodimit dhe ka punuar me programime për të ndërhyrë në paketën e sigurisë së shkollës dhe sygjeron të bëhet një projekt ku të bëhet identifikimi i gjurmimit të fytyrës së nxënësve në bazë të fotografisë së tyre të marrë në fillim të vitit shkollor dhe përmes tij krijohet një sistem gjurmimi, për çdo nxënës, sa herë hyn e del nga shkolla. Në këtë rast edhe verifikohen lëvizjet e tyre dhe parandalohen largimet e paautorizuara.

Tema e projektit: Si të krijoni një sistem të gjurmimit të fytyrës duke përdorur mjetin Arduino.

Nga ana tjetër mund të kryhen gjurmime të telefonit apo mjeteve metalike që mendohet të mbajnë nxënësit me anë të mjetit mikrobit, dhe mundet të verifikohet nëse një nxënës I mban këto mjete në mjedis shkollor

Tema e projektit: Si të identifikojmë mjetet metalike në mjedisin e klasës me mjetin Mikrobit .

Në lidhje me perimetrin e sigurisë sygjerohet instalimi i një sistemi alarmi. Kur derës i afrohen edhe persona të jashtëm të paidentifikuar, ky sistem sinjalizon kompjuterin e shkollës, vizualisht apo me tinguj, për prezencën e tyre. Personat kompetentë bëjnë verifikimet e duhura para se të lejohet akses.

Tema e projektit : Distanca e sigurisë me mjetin Mikrobit

Ide për projekt të sigurisë janë të shumta, por mbetet prezente nevoja për aksesore dhe mjete shtesë funksionale shtesë ,infrastruktura e të cilave duhet për të zbatuar kodet e krijuara , që ato të behën të dukshme dhe efektive .

Sygjerohet bllokimi i valëve telefonike për përdoruesit e shkollës. Alternativa e komunikimit në perimetrin e shkollës do të ishte rrjeti WI-FI falas, ku nxënësit apo stafi regjistrohen me anë të emailit. Aksesit në internetin e shkollës kufizon aplikacionet e padëshirueshme (këto të specifikohen më vonë nga autoritetet përgjegjëse). Lejohen aplikacionet për komunikim thelbësor.

Gjithashtu, shkollat sygjerojnë përfshirjen në projektin ”Smart City” me anë të pajisjes së cdo ambjenti shkollor brenda perimetrit të sigurisë me përjashtim të tualeteve, me kamera. Tek këto monitorime të kenë akses autoritetet policore dhe drejtoria e shkollës.

ZVAP Peqin

ZVAP Peqin ka në varësi të saj 15 Institucione Arsimore qendër dhe 4 vartëse, procesi mësimor ka vijuar normalisht në të gjithë shkollat, nuk ka pasur problematika. "Paketa e Sigurisë në Shkolla", është zbatuar me përpikmëri. Kordinimi i punës midis drejtorive të shkollave, mësuesve kujdestar, oficer sigurie dhe inspektorit të policisë në komunitet ka qenë i vazhdueshëm, me qëllim sigurinë e nxënësve si brenda dhe jashtë perimetrit të sigurisë në shkollë. Në të gjithë shkollat e Zvap-së Peqin janë dy oficer siguri, me arsim të lartë, përkatësisht të emëruar në dy gjimnazet “Zihni Magani” Peqin dhe, Mustafa Kemal Atatürk” Pajovë, të trajnuar dhe çertifikuar nga Ministria e Brendshme për Oficer Sigurie në Institucionet Arsimore. Përsa i përket kamrave të sigurisë në Institucionet Arsimore kemi vetëm në gjimnazin “Zihni Magani” Peqin. Kamra sigurie të vendosura gjatë perimetrit të jashtëm të sigurisë në çdo shkollë nuk ka.

ZVAP Cërrik

ZVAP Cërrik ka zhvilluar takime me drejtuesit e IAP Cërrik, shërbimin psiko-social, si dhe oficerët e sigurisë në shkolla, me qëllim adresimin e çështjeve problematike, u fokusua në zhvillimin e takimeve informuese me stafet dhe prindërit, në fuqizimin e rolit të psikologut dhe të mësuesit kujdestar. Në datën 04.12.2024 uzhvillua një takim me drejtoreshën e DRAP Korçë znj. Rota mbi problematikën e ndodhura kohët e fundit me një grup prindërisht (prej 75 veta). Sa i takon oficerëve të sigurisë, ju informojmë se ZVAP Cërrik ka 3 oficerë sigurie në shkollat SHMB "Osman Gjini" Mollas, "Gjimnazi Tomorr Sinani" Cërrik, "Gjimnazi Miranda Baku Gostimë". Në lidhje me mundësitë e përfshirjes së projektit "Smart City" në

ruajtjen e perimetrit të sigurisë në shkolla, vlerësojmë se shtrirja e kamerave të sigurisë, kamerave për leximin automatik të targave të automjeteve, të ndërlidhura mes tyre, nëpërmjet të cilave do të realizohet monitorimi dhe identifikimi në kohë reale i mjeteve, që qarkullojnë në akset rrugore ku gjenden shkollat, do të ndihmonte dhe forconte punën në ruajtjen e perimetrit të sigurisë në to.

ZVAP Belsh

Në ZVAP Belsh për vitin shkollor 2024-2025 ka në juridiksionin e saj 15 institucione arsimore, Në gjitha këto janë marë masat për ruajtjen e perimetrit të sigurisë në bashkëpunim me SPSH-të e zonave dhe Policinë Bashkiake. Nga 15 IA vetem shkolla 9-vjeçare Halit Uruçi Belsh ka të instaluar sistemin me kamera sigurie. Për shkollat e tjera Bashkia e ka një projekt për instalimin e kamerave. ZVAP Belsh ka zhvilluar një takim me dt 4/12/2024 në gjimnazin Sami Frasheri Belsh ku prezent ishte dhe drejtoresha e DRAP Korçë Znj. Vinjola Rota drejtues te IA-ve si, prindër të bordit të shkollave, nxënës, oficer sigurisë si edhe punonjësit psiko-social. Është hartuar grafiku për zhvillimin e takimeve në çdo shkollë te ZVAP Belsh për të bashkëbiseduar me pjesëmarrësit për kufizimin e rrjeteve sociale si edhe mos përdorimin e telefonave në shkollë, ku do te jenë pjesëmarrës prindër nxënës mësues dhe përfaqësuesit e ZVAP Belsh.

ZVAP Librazhd

Është vendosur sinjalistika vertikale dhe horizontale në perimetrin e sigurisë në shkolla në Bashkinë Librazhd.

Është realizuar vendosja e kamerave te sigurisë në shkollën e mesme “Ibrahim Muca”,në shkollën 9-vjeçare “Genc Leka”ndërsa shkolla 9-vjeçare “Vilson Blloshmi është në process riparimi për arsye teknike. Në të gjitha shkollat janë vendosur pajisjet për shuarjen e zjarreve. Në Bashkinë librazhd nuk ka semaforë të instaluar. Në bashkëpunim me inspektoriatin vendor të ushqimit janë ushtruar kontrole në lokale,fasfude pranë shkollave të cilat janë të licensuar dhe nik janë konstatuar problem. Janë ushtruar kontrole të vazhdueshme nga IMT për zënien e hapsirave publike dhe ndërtimet pa leje në perimetrin e sigurisë në shkolla dhe më gjërë,nuk janë konstatuar problematika. Janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me te gjitha drejtoritë e shkollave dhe ZVAP Bashkia Librazhd,nuk ka patur problem,procesi mësimore ka vazhduar normalisht. Në ZVAP Librazhd 2 shkolla janë me oficer sigurie.

ZVAP Gramsh

ZVA Gramsh ka zhvilluar mbledhje me dreituesit e shikollave, punonjësit e policisë, DRAP etj, me qëllim marrjen e masave per siguri githëperfshirëse dhe zbatimin në mënyrë

të vazhdueshme të tyre, për të krijuar një mjedis të shëndetshëm dhe të sigurtë për nxënësit. Lidhur me këtë. IAP-të në varësi të ZVAP Gramsh, janë marrë masa sigurie, sa më poshtë si vijojnë:

Në disa IAP janë bërë ndryshime në rregulloren e brendshme të shkollës si:

1. Ngritja e një grupi mbështetës brenda shkollës (me psikologun, punonjës social, mësues dhe nxënës), me qëllim menaxhimin e emocioneve dhe tensioneve, në mënyrë që të parandalohen aktet e dhunës.
2. Grup pune më vete (psikologu ose punonjësi social) për trajnimin e mësuesve me qëllimin parandalimin dhe trajtimin e sjellje jo të dhunshme të nxënësve.
3. Mësuesit kujdestar në bashkëpunim edhe me shërbimin psiko-social kanë zhvilluar tema dhe veprimtari të ndryshme kundër bullizmit, terrorizmit, mbrojtjen nga rreziqet online ose ngacmimet kibernetike, identifikimin dhe adresimin e shenjave të stresit, ankthit dhe dhunës tek nxënësit etj.
4. Është vendosur të ndalohet në mjediset e shkollës disponimi i telefonit celular nga nxënësit dhe mësuesit.
5. Janë ngritur komisionet e sigurisë dhe të shëndetit . si dhe kanë hartuar planet vjetore të këtij komisioni
6. Mbajtja e kontakteve të përditshme me Inspektorin Rajonal të Policisë së Shtetit .
7. Janë krijuar grupet e komunikimit në platformat sociale (kryesisht Whatsapp) me prindërit dhe nxënësit, nga secili mësues kujdestar i shkollës.
8. Janë afishuar në vende të dukshme të shkollës (në hyrie të korridoreve të shkollës) numrat e emergjencave civile.

ZVAP Gramsh ka vetëm një officer sigurie në "Gjimnazin Shefqet Guzi" të cilët kanë marrë masa për identifikimin e nxënësve problematikë dhe kontrollin fizik të tyre.

Nga IAP-të e gjimnazit "Shefqet Guzi", Gramsh ka dalje të emergjencës në rast ziarri, në pjesën më të madhe të AIP-ve mungojnë mjetet zjarrfikëse funksionale.

ZVAP Prrenjas

Në ZVAP Prrenjas muri rrethues është vendosur në 14 shkolla nga 15 shkolla që ka e gjithë ZVAP Prrenjas, perimetri i sigurisë është realizuar në të gjitha shkollat ndërsa pjesa i përket kamerave të sigurisë dhe pajisjeve zjarrfikëse ato nuk është bërë asnjë vendosje e tyre për vitin 2024. Problematikat në ZVAP prrenjas paraqiten si më poshtë:

1. Shkolla "Sali Halili" vazhdon mësimin në ambiente të marra me qera nga Bashkia Prrenjas ,për arsye se godina ekzistuese ka dal jashtë përdorimit nga organet përkatëse.

2. Shkollat nuk kanë kamera sigurie dhe paisje zjarrfikëse.

Problematikë: Raportohet mungesa e një fondi buxhetor të posaçëm për implementimin e Paketës së Sigurisë në Shkolla.

- Prefekti i Qarkut Elbasan i është drejtuar të shtatë bashkive të qarkut me shkresë për planifikim të një zëri të posaçëm në buxhetin e vitit 2025 për të shpenzuar për implementimin e Paketës së Sigurisë në Shkolla.

3. RAPORTIM DHE INFORMIM MBI VEPRIMTARINË E PREFEKTIT TË QARKUT

Nga Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara janë bërë rregullisht raportimet periodike, mujore, tremujore dhe vjetore mbi veprimtarinë e prefektit të qarkut në lidhje me:

- ushtrimin e funksionit të prefektit të qarkut
- marrëdhëniet e prefektit të qarkut me administratën shtetërore
- marrëdhëniet e prefektit të qarkut me organet e vetqeverisjes vendore
- për urdhërat dhe udhëzimet e nxjerra nga prefekti i qarkut
- për veprimtaritë e organit këshillues të prefektit të qarkut
- si dhe për problematika të veçanta.

Është bërë evidentimi i ankesave dhe kërkesave të adresuara pranë S.K.V, ndjekja dhe përpunimi i tyre, kthimet e përgjigjeve për qytetarët në respektim të afateve të caktuara.

4. KOMITETI RAJONAL ANTI-TRAFIK (KRAT)

Prefekti i Qarkut është drejtues i KRAT dhe detyra e tij kryesore është koordinimi, nxitja e bashkëpunimit, monitorimi i zbatimit të planit vendor të veprimit nga anëtarët të Komitetit që janë organe shetërore ose OJF.

Gjatë vitit 2024 anëtarët e Komitetit kanë vijuar punën e tyre për identifikimin proaktiv të VMT (Viktima të Mundshme Trafikimi) ose VT (Viktima Trafikimi).

Mbledhjet e Tryezës Teknike dhe të KRAT janë zhvilluar rregullisht, përkatësisht në datat 22.01.2024, 30.09.2024 dhe 09.10.2024.

Gjatë muajit tetor të nominuar si “Muaji i luftës kundër trafikimit të qënieve njerëzore” u zhvilluan aktivitete ndërjegjësuere në të 7 bashkitë e qarkut me pjesëmarrjen e disa prej anëtarëve të KRAT dhe TT.

Janë dërguar raportet gjashtë mujore dhe raporti vjetor pranë Zyrës së Koordinatorit Kombëtar.

E gjitha kjo veprimtari është realizuar në bashkëpunim me sektorin emergjencave civile.

-Të dhëna lidhur me numrin e VT/VTM dhe fëmijëve në situat rruge:

Bashkia Elbasan: - Raste të fëmijëve në rrezik trajtuar nga NJMF, 92 raste;
- Raste të identifikuara nga skuadrat e terrenit, 15 raste;
- Raste të klasifikuara si VMT ose VT, 2 raste.

Bashkia Cërrik: - Raste të fëmijëve në rrezik trajtuar nga NJMF, 20 raste;

Bashkia Gramsh: - Raste të fëmijëve në rrezik trajtuar nga NJMF, 9 raste.

Bashkia Peqin: - Raste të fëmijëve në rrezik trajtuar nga NJMF, 1 rast.

Organizata Tjeter Vizion ka ofruar asistencë në qendrën rezidenciale për 22 minorenë; 21 viktima të mundshme të trafikimit dhe 1 viktimë trafikimi.

DRAKPA ELBASAN: -Janë të deklaruar 4 raste VMT, të cilat janë përfituese të ndihmës ekonomike dhe një rast përfituese e sigurimeve shoqërore si nënë me tre fëmijë.

5. KOMITETI RAJONAL I ZHVILLIMIT TE TURIZMIT (KRZHT)

Organizimin i takimeve të KRZHT, të thirrura nga Prefekti, protokollimi i diskutimeve në këto takime dhe përgatitja e informacioneve për Prefektin, Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit, bashkitë dhe anëtarët e KRZHT -së me diskutimet dhe sugjerimet rreth problematikave të ndryshme, kanë qënë objekti i punës në Sekretarinë Teknike të Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit.

Investimet në destinacionet turistike, promovimi si dhe marrja e masave të sigurisë për garantimin e një sezoni turistik të suksesshëm ishin drejtimet kryesore të punës në bashkitë e qarkut.

Për vitin 2024 janë organizuar gjithsej 2 takime me antarët e këtij komiteti, në të cilat janë diskutuar;

1. Takimi i parë u zhvillua më datë 12.01.2024 në sallën e mbledhjeve e Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan me temë: “Hartimin e Planit të Masave për Sezonin Turistik Veror 2024”
 - Në mbledhjen e parë të Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit anëtarët diskutuan mbi aktivitetet e organizuara me qëllim promovimin e turizmit, dhe

përmirësimin e kushteve për të rritur cilësinë e ofrimit të shërbimive të nevojshme për rritjen e numrit të turistëve. Në këtë takim u diskutua mbi hartimin e planit të masave në mbarëvajtjen dhe mirë menaxhimin e sezonit turistik veror, si dhe objektivat dhe përgjegjësitë që secili prej institucioneve ka në zbatimin e këtij plani, objektiva të paraqitura si më poshtë :

- Ngritja e njëjseve task-forcë në bashki për menaxhimin e sezonit turistik veror
- Marrja e masave për mirëmbajtjen e rrugëve drejt destinacioneve turistike
- Hartimi dhe zbatimi i planit të masave me përforcime shtesë në destinacionet turistike për garantimin e sigurisë publike
- Zbatimi i programit të punës për evidentimin dhe menaxhimin e mbetjeve urbane
- Marrja e masave për ushtrimin e kontrolleve për garantimin e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorëve.
- Inspektimi dhe kryerja e kontrolleve për respektimin e normave dhe rregullave higjieno-sanitare në objektet turistike
- Organizimi i kontrolleve dhe inspektimeve lidhur me publikimin e çmimeve nga subjektet tregtare
- Vënia në funksion të plotë të zyrave të informimit për turistët.

Në secilin prej objektivave organet kompetente shprehen gadtshmërinë e plotë në përmbushjen e

tyre. Drejtori i policisë theksoi rëndësinë që ka rritja e sigurisë dhe rendit publik në mbarvajtjen e

turizmit dhe relatoi se ishin të përgatitur për të gjitha sfidat që mund të haseshin përgjatë zhvillimeve të aktiviteteve, me qëllim promovimin e zonave turistike.

Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan monitoroi në vazhdimësi ecurinë dhe zhvillimet në sektorin e turizmit , gjithashtu theksoi rëndësinë e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstytucional në përmbushjen e objektivave për një sezon turistik të suksesshëm.

2. Takimi i dytë u zhvillua më datë 17.12.2024 në sallën e mbledhjeve e Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan me temë: “Ecuria, problematikat në fushën e turizmit në qark, si dhe mbi hartimin e planit të veprimit për një sezon turistik të suksesshëm për vitin 2025”,

- **Në mbledhjen e dytë** u diskutua mbi ecurinë e sezonit turistik veror 2024, i cili ka qenë ndër sezonet turistike më të suksesshëm, në raport me vitin 2023 si në shkallë kombëtare ashtu dhe rajonale. Anëtarët diskutuan mbi masat të cilat u morën për mbarëvajtjen dhe menaxhimin e sezonit turistik veror si dhe mbi ecurinë e zbatimit të detyrave në përmbushje të planit të masave për sezonin turistik. Organizimi i

festave lokale sipas kalendarit të paracaktuar dhe aktivitetet me qëllim promovimin e turizmit, ndikuan pozitivisht në rritjen e numrit të turistëve, si dhe u theksua vënia në funksion të plotë të zyrave të informimit për turistët si dhe pasqyrimi i të gjitha aktiviteteve dhe festave të planifikuara për vitin 2025 nga ana e bashkive të qarkut në kalendarin digjital përmes aplikacionit TEA.

Gjatë mbledhjes u diskutua gjithashtu mbi zbatimin e programeve të pastrimit dhe menaxhimit të

mbetjeje urbane brenda dhe jashtë qyteteve, dhe u raportua se masat e marra nga ana e bashkive

sollën mirëmenaxhim të situatës, duke siguruar kështu një ambient të pastër. Nga ana e bashkive u kryen punime në tabelat e reja orientuese, të cilat lehtësuan lëvizjen e turistëve brënda ambienteve të kalasë se qytetit dhe në pikat turistike kryesore të qyteteve

Prioritetet për zhvillimin e turizmit në vitin 2025 mbetet zgjidhja e problematikave të relatuara gjatë mbledhjes të cilat konstatohen si më poshtë

- Mungesa e investimeve në infrastrukturë dhe tabelave orientuese në zonat turistike
- Mungesa e zyrave të informacionit në qendër të qytetit
- Mungesa e investimeve në mirëmbajtjen e objekteve kulturore
- Mungesa e guidave turistike dhe ciceronëve në objektet kultore dhe historike
- Mungesa e muzeve historik në qytete për të treguar lashtësinë e këtyre qyteteve
- Rehabilitimi i tregtarëve ambulant dhe krijimi i tregjeve ushqimore me standardet e duhura

Prefekti z. Ali Mysliu në fjalën e tij shprehu se Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan do të ndjekë në vazhdimësi ecurinë dhe do të monitorojë zhvillimet në sektorin e turizmit , gjithashtu theksoi rëndësinë e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstytucional në hartimin e një plani masash efikas në përmbushjen e objektivave për një sezon turistik të suksesshëm për vitin 2025.

- Në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit Nr.69, datë 30.04.2024 “Për ngritjen e Task-Forcës ndërinstytucionale të sezonit turistik veror 2024”, me objektiv mbarëvajtjen e sezonit turistik veror , u ngrit me urdhër të Prefektit Nr. 54 datë 29.05.2024, funksionoj Task-Forca lokale e Qarkut Elbasan për vitin 2024.

Në datë **18.07.2024** në Sallën e Mbledhjeve të Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan, u organizua mbledhja e Task- Forcës Lokale me tematikë, “Ecuria, problematikat e hasura si dhe rekomandime për përmirësime në mbarëvajtjen e sezonit turistik veror për vitin 2024 ”

6. KOMITETI RAJONAL PËR PARANDALIMIN E RADIKALIZMIT DHE LUFTËS KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

Komitetit Rajonal për Parandalimin e Radikalizmit dhe Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm është krijuar me Urdhrin nr. 185 datë 31.10.2023 të Kryeminitrit “Për krijimin e Komiteteve Rajonale të Parandalimit të Radikalizmit dhe Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm.

Ky komitet drejtohet nga Prefekti i Qarkut dhe është ngritur me qëllim identifikimin dhe referimin e rasteve të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, ndjekjes së të gjitha veprimeve, masave dhe aktorëve të përfshirë në parandalimin e radikalizmit, luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe proceset e rehabilitimit, riintegritit dhe risocializimit të personave të kthyer nga zonat e luftës, në nivel qarku, pranë Koordinatorit Kombëtar për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm.

Përgjatë vitit 2024 anëtarët e Komitetit (institucionet shtetërore përgjegjëse) kanë vijuar punën e tyre normalisht për identifikimin dhe referimin e rasteve.

Janë zhvilluar dy mbledhje me anëtarët e këtij komiteti.

1.Më datë 06.02.2024 u zhvillua mbledhja e parë e cila shënoi ngritjen dhe konstituimin e këtij komiteti, dhe u bë një prezantim i përgjithshëm nga drejtoresha e Qendrës së Koordinimit mbi veprimtarinë dhe rëndësinë e këtij komiteti për identifikimin dhe parandalimin e rasteve që kanë të bëjnë me radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm. Takimi u mbyll me miratimin dhe nënshkrimin e Rregullores së Komitetit Rajonal të Qarkut Elbasan.

2.Më datë 12.12.2024 u zhvillua mbledhja e dytë e komitetit.

Në cilësinë e kryetarit të komitetit në fjalën e tij prefekti vuri në dukje se dhuna në familje është një nga faktoret nxitës për fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm dhe theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe monitorimin e situatës në komunitet për parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Raporti i Policisë konfirmoi se nuk ka asnjë rast penal të lidhur me ekstremizmin, radikalizmin apo financimin e terrorizmit në Qarkun Elbasan. Policia gjithashtu siguroi që ka mekanizma të ngritur për monitorimin dhe parandalimin e rasteve të tilla në bashkëpunim me komunitetin dhe institucionet arsimore.

Shërbimi psikosocial raportoi mbi programet edukative dhe ndërgjegjësuese për të rinjtë. Në shkollat publike dhe private nuk është regjistruar asnjë rast i ekstremizmit. U përmendën aktivitetet si pjesë e fushatës “16 Ditët e Aktivizimit kundër Gjuhës së Urrejtjes dhe Bullizmit”.

Kryetari i Qendrës së Bashkëpunimit Ndërfetar, Dr. Arben Ramkaj, vlerësoi rolin e të gjitha institucioneve dhe theksoi angazhimin e Qendrës në fuqizimin e tolerancës ndërfetare dhe ndërkulturore.

Disa nga rekomandimet e nxjerra në përfundim të mbledhjes renditen si në vijim:

- Vazhdimi i programeve edukative në shkollat publike dhe private për tolerancën dhe mirëkuptimin ndërfetar.

- Zbatimi i projekteve të fokusuara tek roli parandalues i grave dhe nënave në komunitet.
- Rritja e koordinimit midis policisë, institucioneve arsimore dhe fetare për të monitoruar dhe parandaluar fenomenin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.
- Zgjerimi i shërbimeve psikosociale sidomos në zonat rurale dhe me risk të lartë etj...

Gjithashtu **më datë 26.12.2024** në ambientet e Institucionit të Prefektit u zhvillua një trajnim i organizuar nga Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm pranë Ministrisë së Brendshme me temë “Adresimi i rasteve të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit fetar në komunitet si dhe përgjigja ndaj nevojave të të rikthyerve nga zonat e konfliktit”.

7. MROJTJA NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI (MZSH)

Në të gjitha bashkitë funksionojnë repartet e MZSH (mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit). Në bazë të informacioneve nga drejtoritë/sectorët e MZSH pranë bashkive aktiviteti i tyre për vitin 2024 ka qënë si më poshtë;

Në **Bashkinë Elbasan** forcat zjarrëfikëse janë përfshirë në 62 raste të rënies së zjarrit, të ndodhura kryesisht në pyje e masive pyjore, në banesa dhe në automjete. Për neutralizimin e vatrave të zjarrit janë angazhuar gjithësej, rast pas rasti, forca përfshirë këtu forca e policisë, forca bashkiake dhe vullnetarë si dhe forcat e zjarrit, gjithsej 658 . Për fikjen e zjarrit janë përdorur edhe 156 mjete transporti. Janë përfshirë nga flakët 37 raste në pyjee kullota .

Gjatë këtij viti nga zjarri jane perfshire 15 banesa, dëmtim banesash 1. Kemi pasur 12 dëme në biznese. Janë përfshirë nga flakët 166.6 Ha sipërfaqe toke të ndryshme.

Në aktivitetin e MZSH **Bashkia Librazhdi** forcat zjarrfikëse janë përfshirë në 8 raste të rënies së zjarrit, të ndodhura në produkte bujqësore dhe pyje dhe banesa. Për neutralizimin e vatrave të zjarrit janë angazhur gjithsej rast pas rasti, 51 forca përfshirë këtu dhe forca të policisë, punonjës pyjor dhe vullnetarë të ndryshëm. Janë përdorur dhe 11 mjete gjithsej. Janë përfshirë nga flaket 0.51 ha siperfaqe toke me bime te ndryshme. Gjatë këtij viti nga zjarri jane perfshire 2 banesa.

Në **Bashkinë Cerrik** forcat zjarrfikëse janë përfshirë në 22 raste të rënies së zjarrit nga të cilat 20 janë në pyje dhe 2 në banesë. Janë përfshirë nga flaket 17.1 ha siperfaqe bimësi e ulët e djegur.

Për neutralizimin e vatrave të zjarrit janë angazhur gjithsej sipas rastit 43 mjete gjithsej dhe 161 forca zjarrfikës.

Në Bashkinë Belsh forcat zjarrfikëse janë përfshirë në 22 raste të rënies së zjarrit, nga te cilat 18 zjarre në pyje dhe 4 në automjete. Për neutralizimin e vatrave të zjarrit janë angazhur gjithsej sipas rastit 123 forca, përfshirë këtu dhe forca të policisë dhe vullnetarë dhe zjarrfikësin. Ku janë djegur edhe 42.4 Ha bimësi e ulët. Për neutralizimin e vatrave të zjarrit janë angazhur gjithsej sipas rastit 37 mjete gjithsej.

Në Bashkinë Gramsh forcat zjarrfikëse janë përfshirë në 7 raste të rënies së zjarrit nga te cilat 3 janë raste të rënies së zjarrit në pyje e kullota dhe 4 raste janë rënie zjarri në banesë. Janë djegur edhe 1.5 Ha pisha të përshkruar nga zjarri. Për neutralizimin e vatrave të zjarrit janë angazhur gjithsej sipas rastit 42 forca zjarrfikësit, vullnetarë si dhe bashkiake. Kanë adhur në ndihmë dhe 9 mjete gjithsej.

Në Bashkinë Peqin forcat zjarrfikëse janë përfshirë në 1 raste të rënies së zjarrit, të ndodhura kryesisht në pyje. Për neutralizimin e vatrave të zjarrit janë angazhur gjithsej 9 forca zjarrfikëse, përfshirë këtu dhe forca të policisë, vullnetarë të ndryshëm. Janë përfshirë nga flakët 0.7 ha bimësi e ulët si dhe janë përdorur 2 mjete gjithsej.

Në Bashkinë Prrenjas forcat zjarrfikëse janë përfshirë në 22 raste të rënies së zjarrit në pyje, makina si dhe produkte bujqësore. Janë djegur edhe 14.7 Ha pisha të përshkruar nga zjarri. Për neutralizimin e vatrave të zjarrit janë angazhur gjithsej sipas rastit 155 forca zjarrfikësit, vullnetarë si dhe bashkiake dhe policore. Kanë adhur në ndihmë dhe 40 mjete gjithsej.

TABELA PËRMBLEDHËSE E AKTIVITETIT TË SHMZ PËR VITIN 2024

BASHKIA	FORCA TE PËRFSHIRA (Forca zjarri/policore/v ullnetarë/ Sherbim pyjor)	ZJARRE NË BANESË	MJETET E PËRDORURA	RASTE ZJARRI TOTALE	PYJE KULLOTA BIMESI TË DJEGURA (Ha)
ELBASAN	658	15	156	62	6.6 Ha pisha 53.8 Ha bimësi e ulët 82 Ha Ah e Dushk

					të djegura
LIBRAZHD	51	2	11	8	0.51 Ha bimesi e ulet 6.4 Ha pisha
GRAMSH	42	4	9	7	1.5 Ha pisha e djegur nga zjarri.
PEQIN	9	0	2	1	0.7 Ha bimësi e ulët.
CERRIK	161	2	43	22	17.1 Ha bimësi e ulët e djegur.
BELSH	123	0	37	22	42.4 Ha bimësi e ulët e djegur.
PRRENJAS	155	4	40	22	14.7 Ha bimesi e ulet 3.5 Ha dru I llojit Ah

8. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2024

- ▶ Koordinimi i punës së Sektorit të Monitorimit të Kompetencave Vendore me degët territoriale për zbatimin e programeve të Këshillit të Ministrave.
- ▶ Ndjekja e procedurës për ankesat ose kërkesat e subjekteve fizik ose juridik.
- ▶ Rritja e bashkëpunimit midis Sektorit dhe Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.
- ▶ Monitorim i TASK-FORCAVE në nivel vendor për probleme të ndryshme dhe përpunimi i informacioneve në përfundim të veprimtarisë së tyre.

ANALIZA VJETORE E NËNPREFEKTURAVE

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, të urdhërit nr.50 datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së prefektit të qarkut”, të Rregullores së Brendshme të miratuar me urdhrin nr.67 datë 29.07.2020 “Mbi miratimin e Rregullores së Brendshme ‘Për funksionimin e administratës së Prefektit të Qarkut Elbasan’”, Neënprefektët e rretheve Librazhd, Gramsh dhe Peqin kanë kryer gjatë vitit 2023 detyrat si më poshtë vijon:

1.NËNPREFEKTURA GRAMSH

Veprimtaria e Nënprefektit në Bashkinë Gramsh është zhvilluar në përputhje të plotë me përcaktimet e Ligjit 107/2016 “Per Prefektin e Qarkut”,si dhe të Rregullores së Brendshme “Per organizimin dhe funksionimin e Prefektit të Qarkut”,mbeshtetur në Urdherin nr.50,date 12.04.2017 të Kryeministrit “Per miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”.

Mbeshtetur në nenin 8 të Rregullores së Brendshme ju informojmë:

Është realizuar ndjekje periodike e përmbushjes së detyrave të caktuara në zbatim të programit të Qeverisë nga institucionet vendore,drejtori vendore e rajonale.

Është përpiluar raporti mujor mbi veprimtarinë dhe plotësimin e detyrave në Institucionet qendrore në territorin e Bashkisë Gramsh.Ky raport i është dërguar rregullisht e në afat Prefektit të Qarkut Elbasan.

Nënprefekti ndjek në përditshmeri veprimtarinë e punonjësit të Gjendjes Civile, si funksion i deleguar.Konstatohet se kjo veprimtari udhëhiqet nga ligjshmeria dhe ofrimi i shërbimit cilësor ndaj qytetarëve.

Ka trajtuar me seriozitet të gjitha kërkesat e qytetarëve,si dhe ka bashkëpunuar me Bashkinë Gramsh e Institucione të tjera për të zgjidhur gjithçka që është ligjore dhe e mundshme.

Ka ndjekur rregullisht,duke përfaqësuar Institucionin e Prefektit në të gjitha ceremonitë zyrtare, në aktivitetet kulturore-sportive,në festat e komuniteteve fetare,etj.

Ka respektuar të gjitha ftesat e Qendrave e Organizmave të interesuara për zhvillimin në zonën tonë (ECO-ALBANIA,PNUD,CARITAS AUSTRIA,FORUMI I GRUAS ELBASAN,etj.)

Ka marrë pjesë në takime të zhvilluara me përfaqësues të komuniteteve të fshatrave,atëherë kur ka patur shqetësime që kërkonin zgjidhje.

Mbeshtetur në informacionet e ardhura nga institucionet qendrore që veprojnë në Bashkinë Gramsh po ju informojmë mbi punën e bërë nga ana e tyre për vitin 2024 si më poshtë :

Shërbimi i Gjendjes Civile.

Ky shërbim mbështet në ligjin nr.10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar, të akteve të tjera ligjore e nënligjore. Shërbimi i gjendjes civile deri në fund të muajit shtator 2023 veprimi në zbatim të shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile nr.4521, datë 05.05.2022 “lidhur me ushtrimin e veprimtarisë në zbatim të VKM nr.257, datë 29.04.2022 “Për miratimin e strukture, të organikes dhe të numrit të nepunesve të shërbimit të gjendjes civile në bashki/njesi administrative dhe në zyrat e gjendjes civile pranë prefektit të qarkut”, të ndryshua. Pas datës 1 tetor 2023 të gjitha shërbimet për qytetaret kryhen në portalin e-albania nga të gjitha zyrat e gjendjeve civile, bashki/njesi administrative dhe zyres së arkivit. Zyra e gjendjes civile në bashkinë Gramsh kryen shërbimet në kontakt direkt me qytetaret për mbajtjen e akteve të lindjes, vdekjes dhe martesës të ndodhura brenda territorit të Republikës si dhe për regjistrimin të akteve të lindjeve, vdekjeve dhe martesave të ndodhura jashtë territorit të Republikës, për shpalljet e martesave, për ndarjet dhe bashkimet familjare, për ndryshimin e emrit/mbiemrit në rast të papershatshmerisë, për njohjen e atesise, për rregjistrimin e shtetasve të huaj.

Vlerësojmë që shërbimi ndaj qytetareve ka qenë në lartësi e kërkuar në zbatim të ligjit, shërbim korrekt dhe i shpejtë.

Për vitin 2024 janë dhënë 212 vula për autentifikimin e çertifikatave e dokumentave të leshuara brenda vendit për jashtë shtetit.

Shërbimi ndaj Institucioneve shtetërore dhe zyrave noteriale është realizuar përmes sistemit SQDNE.

Për vitin 2024 janë rregjistruar **173 lindje gjithsej** (69 lindje brenda vendit dhe 104 lindje jashtë vendit), **vdekje gjithsej 185** (178 brenda vendit dhe 7 nga jashtë vendit), **martesa gjithsej 123** (69 brenda vendit dhe 54 nga jashtë vendit), ndarje/bashkime familje janë rregjistruar 228 (223 ndarje dhe 5 bashkime familje)

Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor:

Për vitin 2024 puna e Shërbimi Epidemiologjisë dhe Shëndetit Mjedisor, është mbështetur në zbatim të ligjit Nr.10138, datë 11.05.2009, “Për Shëndetin Publik”, të ligjit Nr.15/2016 “Për Parandalimin dhe Luftimin Infeksionit dhe Sëmundjeve Infektive”, ligjeve që disponon në punën e përditëshme, VKM Nr.379, dt. 26.05. 2016, Për Miratimin e Rregullores “ Cilësia e Ujit të Pijshëm”, të Urdhërit të Ministrisë Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr.81, datë 10.02.2020, me nr.744 prot., dt.10.02.2020 “Për miratim të protokolleve dhe algoritmeve për parandalimin e sëmundjes COVID-19 në vend”, Kalendarit Kombëtar për Vaksinimin, Urdhërave, Udhëzimeve, Rregullores higjieno-sanitare të Ministrisë Shëndetësisë, Standartit Shqiptar i Ujit të pijshëm, Manualeve, rregullores së etiketimit - ambalazhimit të Kripës së Jodizuar, të shkresës së Ministrisë Shëndetësisë me Nr.2200, datë 08.05.2015 “Përshkrim i Funkcioneve të Shërbimit të Shëndetit Mjedisor në Strukturat Rajonale të Shëndetit Publik”, rregullores brendëshme e programit vjetor 2024 të NJVKSH-

së,të planit punës vjetor,6-mujor,3-mujor,mujor dhe grafikut të përditëshëm të punës së Shërbimit Epidemiologjise dhe Shëndetit Mjedisor:

Ne qender te vemedjes se punes edhe per vitin 2024 ka qene marrja e masave per parandalimin e perhapjes se Covid-19 dhe semundjeve te tjera infective duke testuar, hetuar, gjurmuar dhe izoluar rastet dhe vatrat te personave te rezultuar pozitiv. Problematika nuk ka patur.

Testimet jane kryer ne te gjitha pikat e percaktuara si prane NJVKSH, Urgjenca e Spitalit dhe Qendrat Shendetsore.

Jane marre gjithsej 220 tampone dhe kane rezultuar 11 raste pozitiv. Ne mesues 0 raste pozitiv, nxenes 0 raste pozitiv dhe personel shendetesor nuk ka raste me pozitivitet. Jane raportuar si zakonisht sipas formularit 14/SH: raste me diarre pa gjak 747, raste me infeksione respiratore te siperme 4680, raste me infeksione respiratore te poshteme 2699. Per sektorin e vaksinimit jane realizuar plotesisht objektivat sipas kalendarit Kombetar dhe Udhetimeve te ISHP. Eshte aplikuar vaksinimi anti covid-19 tek personeli shendetesor, mesues, edukatore, polici, fasoneri, hotel-turizem, te semure kronik mbi 60 vjeç. Ne total vakcina anti Covid-19 (Nga 15 marsi 2021 deri 31.12.2023) jane aplikuar 46 doza. Doza te para 4, doza te dyta 0, doza te treat 28, doza te katerta 14 dhe doza te pesta 0. Pe vitin 2024 jane terhequr 126 doza dhe aplikuar 46 doza. Aktualisht gjendje jane 0 doza te llojit Pfizer qe ruhen ne minus 90 grade ne NJVKSH Elbasan dhe 80 doza humbje. Gjate vitit lidhur me vaksinën kunder gripit sezonal u terhoqen 3500 doza dhe u aplikuan 3349 doza, gjendje jane 151 doza. Ne lidhje me vaksinën HPV per vajza 13 vjeçare u terhoqen 235 doza, jane perdorur 235 dhe jane gjendje 0 doza.

Per vaksinat pediatike eshte operuar sipas kalendarit dhe detyrimisht jane vaksinuar 112 femije te lindur me 100 dozen e lindjes.

Shërbimin mjedisor

Cilesia e ujit te pijeshm qe konsumojne banoret e rrethit Gramsh sipas analizave fiziko kimike dhe bakteriologjike ka qene e mire. Analiza ne laboratorin fiziko-kimik jane kryer ne total 2271 mostra dhe brenda normave jane 2061 mostra kurse jshte normave 212 (por duhet kuptuar vetem per klorine lire qe brenda norme quhet 0.5 mg/l, por qe ka qene mbi ose nen kete sasi dhe quhen jashte normave sopas VKM nr.379 date 26.05.2016“Per miratimin e e rregullores :Cilesia e ujit te pijshem”) Total tregues fiziko-kimik per ujin e pijshem e Hipokloriteve Na+Ca jane 16715.

Ne laboratorin bakteriologjik per ujin e pijshem jane analizuar 4728 mostra nga te cilat kane rezultuar brenda normave 4546 dhe jashte normave 182 mostr Ne toltal ne laboratorin mikrobiologjik per vitin jane kryer analiza Koliforme, Escherichia Coli, streptokoku fekal 4728 analiza .

Ekzaminimet mikrobiologjike dhe imunologjike te kryera gjate periudhes sipas kerkesave te sherbimit spitalor, ambulator dhe urgjences jane ne total 2436 me raste positive 251. Gjithashtu sipas planit jane kryer 696 monitorime, ne subjekte arsimore, shendetesore, prodhuese, tregtare, fasoneri etj, Sipas sektoreve jane kryer 195 monitorime ne higjenen e ushqimit dhe ushqyerjes, 261 monitorime ne higjenen komunale, 66 monitorime ne higjenen shkollore/feminore dhe 12 monitorim ne higjenen e punes.

Drejtoria e Shërbimit Spitalor Gramsh

Ne zbatim te ligjit nr.10383, date 24.02.2011 “Per sigurimin e detyrueshem te kujdesit shendetesor ne Republiken e Shqiperise” dhe te VKM nr.23, date 18.01.2023 “Per financimin e sherbimeve shendetesore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve te kujdesit shendetesor”, gjate vitit 2024 stafi mjeksor dhe personeli ndihmes kane qene ne gadishmri te plote 24 ore dhe kane pritur gjithsej 24696 paciente

Urgjenca: Ne repartin e urgjences me 5 shtreter jane paraqitur 20521 pacienet nga te cilet vizita/konsulta 12919 paciente, shtrime ditore 2859 pacient, mjekime dhe intervente 4743 paciente.

Shtrime ne spital : Jane shtruar gjithsej jane 2115 paciente dhe sipas reparteve :

reparti pathologji me 35 shtreter jane 512 te shtruar, transferuar 30, vdekur 10

reparti i kirurgjise me 25 shtreter 346 te shtruar, operuar 27, transferuar 26, vdekur 1

reparti pediatrie me 23 shtreter, shtruar 905 paciente, transferuar 18

reparti i obsetrikes me 32 shtreter te shtruar 352, transferuar 14, lindje 20, aborte 21.

Treguesit jane si vijon: gjate vitit, dite pacient 9909, dite qendrimi mesatar 4.67, shfrytezim shtrati 23.61, xhiro shtrati 18.44.

Ne poliklinike jane vizituar/konsultuar te rekomanduar dhe te siguruar 4175 paciente. Ekzaminime radiologjike jane kryer gjithsej 6685 per paciente te siguruar. Nga laboratorit kimik jane kryer ne total 81354 analiza per pacient te siguruar dhe te pasiguruar qe vijne ambulator dhe nga urgjenca.

Bazuar ne Udhezimin e Minsitrise se Financave nr.2, date 19.01.2023 “Per zbatimin e buxhetit te shtetit 2024” fondi i pagave eshte realizuar nga 154634500 mije lek plan ne 154616418 mije lek fakti (99.98 %). Po keshtu edhe sigurimet shoqerore dhe shpenzimet operative jane realizuar perkatesisht ne 99.83 % dhe 99.99 % . Ne shpenzimet operative 37.2 % e zene medikamente e materiemale mjekimi, 0.5% lende djegese, 20.5 % eneregji dhe uje dhe pjese tjeter nga totali e zene ushqimi, nafta, pjese kembimi e goma, mirembajtje aparaturash, trasnporti i te semureve per hemodialize, mbetjet spitalore (zene 3.2% te totalit) kancelari, material pastrimi etj. Investime nga buxheti i shtetit per vitin 2024 nuk ka patur.

Perpjekjet per furnizim me barna te domosdoshme dhe medikamente per trajtime mjeksore kane qene maksimale qe te mos mungojne asnjehere ne siptal dhe qe qytetaret te mos i

blejne. Behet transportimi i te semureve per dialize tre here ne jave per Elbasan per pacientet. Punohet vazhdimisht per permiresimi e kushteve higjeno-sanitare brenda dhe jashte ambjentit.

Sherbimi spitalor Gramsh ka nevoja emergjente per investime sidomos ne aparatura mjeksore.

Zyra Vendore Arsimore Gramsh:

Gjate periudhes Janar-Dhjetor 2024 stafi i punonjesve te ZVA Gramsh ka realizuar te gjitha detyrimet ligjore te percaktuara ne pershkrimin e punes ne urdherin nr 773 date 20.09.2019 “ Per miratimin e pershkrimeve te vendeve te punes per punonjesit e DPAP,DRAP dhe ZVAP-ve” Aktiviteti dhe veprimtaria e personelit punonjes te ZVA eshte mbeshtetur ne ligjin 69/2012 “Per sistemin arsimor parauniversitar ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar , ne vendimin 99 dt 27 .2 2019 “Per krijimin mynyren e organizimit e te funksionimit te te Drejtorise se Pergjithshme te Arsimit Parauniversitar” , ne urdherin nr 252 dt 30 .04 ,2019 per miratimin e rregullores per organizimin dhe funksionimin e Drejtorise se Pergjithshme te Arsimit Parauniversitar ,ne Rregulloren e Brendshme per funksionimin e Zyres Vendore Arsimore Gramsh nr 140 dt 25.01.2021 e ndryshuar,ne udhezimin 08 dt 03.05.2024 “Per procedurat e pranimit,te pezullimit dhe te largimit te mesuesit ne nje vend te lire pune si dhe per administrimin e portalit “Mesues per Shqiperine” i ndryshuar ,ne udhezimin per fillimin e vitit shkollor 2024-2025 , si dhe ne udhezimin nr 14 dt 10.07.2023 “ Per numrin e nxenesve per klase dhe normat e punes mesimore ne institucionet e arsimit parauniversitar “ si dhe te gjitha aktete ligjore e nenligjore te nxierra nga institucionet eprore si MAS, AKAP ,DRAP,ASCAP etj.

Disa nga veprimtari të dhe aktivitetet më të rëndësishme të realizuara gjatë vitit 2024 kanë qenë:

Jane monitoruar per zbatimin e te gjitha akteve ligjore e nenligjore qe rrjedhin nga ligji 69/2012“Per sistemin e arsimit parauniversitar ne Republiken e Shqiperise ne te gjitha institucionet arsimore ne vartesi si : zbatimi i kurrikules shkollore,caktimi i kurrikules me zgjedhje per çdo shkolle ,ngarkesa mesimore ,infrastruktura e shkollave, planifikimet vjetore dhe periodike te drejtorive te shkollave dhe mesuesve, planifikimet per projektet qe implementohen ne shkollat tona si SHQK,A/Z ,BDSH ,klasat sportive, furnizimi me tekste shkollore ,lendet djegese ,regjistrimet ,paketa e sigurise ne shkolla etj

Komisioni Ad-hoc i ngritur ne ZVA ka ndjekur e zbatuar me korrektesi udhezimin nr 8 .dt 03.05.2024 “ Per procedurat e pranimit te pezullimit dhe te largimit te mesues nga nje vend pune si dhe administrimin e portalit ‘Mesues per Shqiperine “ per çdo procedure te zhvilluar.

Eshte monitoruar zbatimi i kurrikules sipas udhezimeve perkatese dhe metodologjive dhe standartet te procesit mesimor ne te gjitha institucionet arsimore si dhe ka ndjekur me perparesi mbarvajtjen e ketij procesi ne te gjitha shkollat qe mbulon .

Eshte konstatuar se procesi mesimor ka vijuar normalisht pa probleme duke realizuar me sukses dhe ne permbushje te detyrimeve ligjore nga te gjitha institucionet arsimore ne vartesi te ZVAP Gramsh. Jane krijuar kushte normale per zhvillimin e procesit mesimor ne te gjitha shkollat tona.

Nuk kane munguar pajisjet dhe mjetet shkollore ,mjetet didaktike ,ngohja etj.Ne shtator para fillimit te vitit te ri shkollor 2024-2025 u moren te gjitha masa ne bashkepunim me bashkine duke nderhyre ne riparimin dhe permiresimin einfrastruktures ne te gjitha shkollat qender dhe vartese si lysterjeve e mjediseve ,riparime ,sigurimin e ujit te energjise etj.

Ne gjimnazin “ Shefqet Guzi viti shkollor 2024-2025 filloi ne mjedise plotesisht te rikonstruara me laboratore bashkekohore .Ne nentor 2024 filloi rikonstruksioni i shkolles “Rilindja”.

ZVAP ka monitoruar punen dhe aktivitetin e sherbimin psiko-social per te gjitha IA .Sot sherbimi psiko-social eshte shtrire ne te gjitha shkollat . Gjitheperfshirja ka qene dhe mbetet prioritet i yni dhe ne sherbim te çdo femije me aftesi te kufizuar (AK) ne kete vit mesimore jane emeruar 20 mesues ndihmes nga portali “Mesues per Shqiperine” dhe nga mesuesit qe rezultuan pa ngarkese mesimore ne sherbim te 43 nxenes me aftesi ndryshe (AK).

Programi kombetar i zhvillimit profesional ne kete vit ka qene prioritet i MAS dhe ZVA dhe ne bashkepunim me ASCAP,DRAP, AKAP dhe IAL ka ndjekur dhe monitoruar seancat trajnuese ne çdo lende e mesues te zhvilluara ne UE “Aleksander Xhuvani” Elbasan.Rrjetet profesionale kane zhvilluar trajnime me mesuesit sipas planifikimit vjetor. Komisioni i MSH ne ZVA pergatiti dhe administroi me sukses provimet e MSH 2024 ,PKAB,VANAF te zhvilluara gjate muajve maj - qershor 2024. Jane realizuar detyrat edhe ne administrimin e olimpiadave per vitin 2024 ne te gjitha lendet .

Jane realizuar trajnime me drejtues te shkollave kordinator te SHQK,Projekteve “Shkolla per Shendetin,Arte/Zeje ,Klasave Sportive. Ne IA te ZVA Gramsh jane implementuar dhe zhvillohen projektet: ne 10 shkolla SHQK, ne 7 shkolla Arte/Zeje,ne 4 shkolla Bejme detyrat e shtepise,ne 3 shkolla klasat sportive volejboll e basketboll.

Projekti ‘Element IT’ eshte imlementuar e shtrire ne 3 shkolla ne kete vit shkollor .Per kete jane instaluar labororet SmartLab ne te tre shkollat 9-vjeçare te qytetit.

Regjistrimet ne klasat e para ,te dhjeta dhe ne arsimin profesional ishin ne fokusin e punes se stafit te zyres per fillimin e vitit shkollor 2024-2025 . Nje pune voluminoze u realizua per parashikimin e nr te nxenesve, te nr te klasave dhe ndarja e ngarkeses mesimore per cdo mesuesit sipas profileve perkatese per vitin 2024-2025.

Per vitin 2024-2025 per shkak te renies se numrit te nxenesve u mbyllen 2 drejtori shkollash (Drize dhe Mashan) qe kaluan vartese si dhe 2 shkolla te A F (Kuterqare dhe

Brahimas).Ne vartesi te ZVA Gramsh funksionojne 47 IA .Ne kete vit shkollor nuk u hapen 2 klasa te 10 ne shkollat Tunje e Lenie.

Ne perputhje me udhezimin Nr 8.dt 3.5.2024 u zhvilluan procedurat e pikezimit ne institucionet ku ra ngarkesa mesimore. Nga proçesi i konkurimit 13 mesues rezultuan pa ngarkese mesimore ne fillim te vitit shkollor 2024-2025 por u sistemuan si mesues ndihemes.

Numri i punonjesve arsimor per vitin 2024-2025 eshte 348 nga 367 qe ishte nje vit me pare.

Jane monitoruar per periudhen janar -dhjetor 2024 rreth 11 institucione arsimore per cilesine e realizimit te veprimtarise mesimore-edukative dhe per permiresimin e shebimit arsimor parauniversitarsi dhe per drejtimin dhe menaxhimin e IA ,realizimi i programit,detyrat qe rrjedhin nga zbatimimi i urdherit nr 31 dt 28.01.2020 “Per miratimin e rregullores per funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare ne Republiken e Shqiperise” etj..

U kryen procedurat e perzgjedhjes se teksteve per vitin 2024-2025 dhe u monitorua shperndarja e teksteve falas ne cdo shkolle.

Eshte monitoruar regjistrimi i nxenesve te klases se pare dhe te dhjete ky proçes ne kete vit u realizua online.Ne klasen e pare u regjistruan 142 nxenes dhe ne klasen e 10 jane regjistruar 170 nx.

ZVA ka vene ne sherbim te vazhdueshem te gjitha dekontacionet e nevojshme per funksionimin e IA.Nga punonjesit e zyres eshte dhene asistencen e duhur ne kohe reale per çdo urdher,udhezim apo vendim ne zbatimin sa me korrekt te tyre.Jane plotesuar te gjitha detyrat e kerkuara nga institucione ne vartesi te MAS.

Ne bashkepunim MAS ,DRAP me QKF dhe bashkine jane zhvilluar nje numer i madh aktivitetesh ne kuader te 80-vjetorit te çlirimit te atdheut. Ne rang kombetare u zhvilluan konkurset ne lenden e gjuhes shqipe si dhe aktivite sportive ne futboll per djem dhe volejboll per vajza , duhet theksuar qe ekipi i volejbollit te vajzave te gjimnazit “ Shefqet Guzi “ zuri vendin e dyte ne rang vendi.

Per vitin 2024 buxheti per ZVA Gramsh eshte realizuar ne masen 100% .ZVA Gramsh nuk ka detyrime te mbartura apo te lindura rishtazi.

Mbeshtetur ne udhezimin nr 12 date 16.06.2022 per ngritjen dhe funksionimin e komisionit per vleresimin psiko-social te punonjesve arsimore dhe punonjesve te tjere te institucioneve arsimore parauniversitare u vleresuarn punonjesit e rinje te punesuar pas periudhe 3-mujore (periudhe e proves) kjo u realizua ne daten 17 dhjetor 2024.

Gjendja e objekteve shkollore eshte relativisht e mire por ne disa shkolla vartese me numer te vogel nxenesish gjendja ka ardhur ne perkeqesim dhe kerkon nderhyrje . do te negociojme me bashkine qe edhe ne keto shkolla proçesi mesimor te zhvillohet me kushte normale .

ZVAP Ka monitoruar punen e dekontacionit shkollor ne sisitemin SMIP .Nga mesuesit ne kete drejtim eshte bere nje pune e kujdesshme qe meriton vleresim maksimal.

Dega e Thesarit Gramsh:

Baza ligjore eshte ligji nr.9936, date 26-.06.2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise”, Ligji 84/2022 “Per buxhetin e vitit 2023” Udhezimi 9, date 18.09.2018 “Per proçedurat standarte te zbatimit te Buxhetit”,ligji i Buxhetit nr.97/2023,dt 7.12.2023 “Per buxhetin e vitit 2024”.

Dega e thesarit Gramsh ka vijuar normalisht punen ne angazhimine detyrave funksionale ne SIFQ per te gjitha institucionet buxhetore qe operojne me te dhe aplikon arshiven elektronike.

Per periudhen janar-dhjetor 2024 nuk ka pasur pengesa apo probleme ne realizimin objektivave.

Jane likuiduar brenda fateve ligjore pagesat per pagat dhe te gjitha llojet e faturave per likuidim. Sipas grafikut kane kaluar rregullisht pagat, sigurimet shoqerore dhe shendetesore, tatimi mbi page, ndihma ekonomike, paaftesia, shpenzimet operative si dhe investimet per te gjitha instiucionet te cilat nuk kane detyrime te prapambetura per pagat, sigurimet shoqerore dhe shendetesore.

Gjate muajit dhjetor 2024 u likuidua ndihma e menjehershme prej 15000 leke per familjet qe trajtohen me ndihme ekonomike dhe personat me aftesi te kufizuara.

Prioritet i eshte dhene detyrimeve te institucioneve per faturat e OSHEE dhe ujesjellesit dhe nuk ka detyrime te palikuiduara te faturimeve.

Te ardhurat janar-dhjetor 2024 jane 94 595 mije leke nga te cilat: Pushteti vendor bashkia Gramsh 94 172 mije leke.

Institucionet Nacionale: Drejtoria e Sherbimit spitalor 187 mije lek, Njesia e Kujdesit Shendetsor Paresor 97 mije lek dhe Zyra vendore e Arsimit 130 mije lek,Dega e Thesarit 9 mije leke.

Shpenzimet faktike jane realizuar 1 927 783,89 mije lek nga 2 044 063,43 mije lek te planifikuara ose 94.31 %.

Investimet jane realizuar me objekte si vijon:

Rikonstruksion i zyrave te KB dhe katit te I te Bashkise 5389429 lek plani ne 4673548 lek fakti

Rikonstruksion i rruges se fshatit Ceruje 26174256 lek plan ne 26174256 lek fakti

Sistemin-asfaltim lagjes “Xhile Liçi” 8732756 lek plani ne 8732756 lek fakti

Mobilie per shkollen 9-vjeçare “Asllan Shahini” 3743730 lek plani ne 3743730 lek fakti

Rikonstruksion i gjimnazit “Shefqet Guzi” nga 63997123 lek plani ne 63997122 lek fakti

Permiresim i kushteve te banimit per komunitetin egjyptian	11644865	plani	11644862
fakti			
Sistemim- asfaltim i lagjes "Ish-depo e duhanit"	7000000	lek plani ne	7000000 lek
fakti			
Ndertimi i shkalleve ne segmentin "Xhile Liçi-Llapushaj"	2907480	lek plani ne	2907480
fakti			
Blerje mjetesh te renda per Drejtorine e infrastruktures	20000000	lek plani ne	20000000
lek fakti			
Meremetim kanali ne degezimin Bersnik-Mashan	5700002	lek plani ne	5392139
lek fakti			
Pajisje mobilie per arsimin e mesem	6230756	lek plani ne	4258800
lek fakti			
Pyllezime te reja	837120	lek plani ne	837120
lek fakti			
Sistemimi-asfaltim i rruges ne fshatin Mashan	37050000	lek plani ne	37050000
lek fakti			
Ndertim pritash ne lumin Devoll	34455011	lek plani ne	34455010
lek fakti			
Blerje automjeti per transport	1520000	lek plani ne	1340017
lek fakti			
Bashkefinancim per permiresim kushtesh (kom.egjy.)	5298136	lek plani ne	4889407
lek fakti			
Rikonstruksion shkolla Rilindja	23000000	lek plani ne	23000000
lek fakti			
- Totali	Nga 263680664	lek plani ne	258364927 lek fakti ose mbi 95%

Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh

Kjo Zyre per shkak te reformimit nuk ka depozituar informacion vjetor per veprimtarine e vet.

2.NËNPREFEKTURA LIBRAZHD

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2024 në Nënprefekturën e Librazhdit përgjithësisht realizimi i detyrave të ngarkuara në bazë të ligjit dhe sipas planeve të puns është realizuar në kohën e duhur dhe me përgjegjësi, duke i dhënë përparësi shërbimit ndaj qytetarëve dhe duke ndjekur ankesat e tyre për problemet e ndryshme që ata kanë, ku kemi kryer dhe

takime individuale me kryetarët e bashkive dhe të institucioneve për tu dhënë zgjidhje ankesave dhe problemeve që ata kane .

Gjatë vitit 2024 janë zhvilluar takime të rëndësishme si më poshtë:

1-Takim me emergjencat civile në praninë dhe të dy Kryetarëve të Bashkisë Librazhd dhe Prrenjas për sezonin veror dhe takim për sezonin dimëror.

2-Takim me Institucionet Zjarrëfikës Librazhd dhe Prrenjas.

3-Takim në Spitalin Librazhd me mjekë dhe infermierë.

4-Takim sensibilizues kundër dhunës në familje.

5-Takim në kuader të tetorit rozë.

6-Takim kundër trafikimit të fëmijëve.

7-Takim për disa projekte të reëndësishme nga Shoqata Agromjedisore për punësimin e të rinjve në rrethin tone etj....

Gjithashtu gjatë vitit 2024 në Nënprefekturën tonë ka pasur plot raste dhënie titujsh nderi për veprimtarinë dhe kontributin e qytetarëve ndër vite ku edhe ne si Nënprefekturë i kemi dhënë rëndësi të vecante ketyre takimeve duke qenë shumë aktiv.

Sigurisht një vëmëndje të rëndësishme i kemi kushtuar datave historike dhe veprimtarive të kryera me rastin e këtyre festave në të dyja Bashkitë.

Nga informacionet e ardhura nga institucionet qendrore po ju informojmë mbi punën e kryer për vitin 2024.

Shërbimi i Gjendjes Civile

Ky shërbim mbështetet në ligjin me nr 10129, datë 11.05.2009 për Gjendjen Civile i ndryshuar ,të akteve të tjera ligjore e nënligjore.

Për vitin 2024 shërbimi i Gjendjes Civile veproi në zbatim të shkresës së D.P.Gj.C nr 4521 datë 05.05.2022 lidhur me ushtrimin e veprimtarisë në zbatim të VKM nr. 257 datë 29.04.2022 për miratimin e strukturës të organikës dhe numrit të nënpunësve të shërbimit të Gjendjes Civile në Bashki dhe njësi administrative dhe në zyrën e Gjendjes Civile pranë Prefektit të Qarkut, të ndryshuar Zyra e Gjendjes Civile në Bashkinë Librazhd dhe Prrenjas shërben si sportel fizik, ndërsa Z.GJ.C në njësitë vendore dhe Z.GJ.C pranë Nënprefekturës shërbejnë online. Pas dates 01.10.2023 të gjithë shërbimet kryhen në portalin e-albania në të gjithë zyrat.

Drejtoria e shërbimit spitalor

Pranë spitalit Librazhd ushtrojnë aktivitetin e tyre mjeksor, mjekë të specialiteteve të ndryshme, si dhe një numër personeli infermierë, e sektorë mbështetës, të cilët bëjnë të mundur mbarëvajtjen e shërbimit spitalor.

Pranë spitalit Librazhd gjatë vitit të kaluar e deri më sot nuk ka pasur raste epidemiologjike por vetëm viroza të stinës të cilat janë trajtuar me kujdes të vecantë nga stafi i këtij spitali.

Sa i perket gjendjes aktuale për personel mjeksor dhe infermierë është plotësuar pjesa më e madhe e shërbimit por përsëri ka mangësi. Gjendja për godinat e spitalit në përgjithësi është e kënaqshme.

Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor

NJVKSH Librazhd mbulon dy Bashkitë Librazhd dhe Prrenjas.

Ofrimi i Shërbimit Shëndetësor parësor është i organizuar në 10 Qendra Shëndetësore simbas Njësive vendore (me përjashtim të Lunik-Steblev është një Qëndër).

Në përgjithësi gjendja e Objekteve të ofrimit të shërbimit shëndetësor është e mirë vitet e fundit nga programi për ndërtimin dhe rikonstruksionin e objekteve Shëndetësore dhe Librazhdi ka përfituar disa investime si Orenjë, Togëz, Steblevë, Rrajcë, Prrenjas etj., po dhe nga donacione të shoqatave bamirësie si Zgosht, Polis etj, ka vend për përmirësim të kushteve të ofrimit të shërbimit në QSH (psh Qukës ndërtim nga e para objekt i amortizuar), dhe objekte të ambulancave në fshatra të ndryshëm që kërkojnë Rikonstruksion dhe mirëmbajtjen të përvitshme të cilat jemi në fazën e kompletimit të dokumentacionit për vitin 2024.

Në të gjithë territorin mbulohet Ofrimi i shërbimit mjekët familje dhe infermier, megjithëse ka mungesë për mjekë/nga 35 plan fakt 27, shërbimit është mbuluar nga mjekët në dispozicion. Aktualisht ka mungesë mjekësh (nuk ka në listë pritje) në Polis, Qendër, Qukës, Rrajcë.

Nga stafi mjekësor ofrohet dhe shërbimi vizitave në familje.

Vaksinimi bëhet sipas kalendarit shtetëror të vaksinimit dhe është në masën 100%.

Vaksinimi i vajzave në moshën 13 vjeç është i kënaqshëm ku e gjithë sasia e dozave të Vaksinës HPV është aplikuar.

Krahas ekzaminimeve të tjera rëndësi i kushtohet dhe Ekzaminimi i kancerit të gjirit (ekzaminimi mamografi) cdo vit mamografia e Lëvizshme është në Librazhd dhe Prrenjas ku janë ekzaminuar rreth 390-400 gra dhe vajza.

Rëndësi të veçantë zë dhe ofrimit i paketës bazë të Check Up, shërbim i cili ofrohet në çdo

Qendër Shëndetësore cdo ditë me përjashtim të Lunik, Orenjë, Stravaj dhe Polis që ofrohet me planifikim të mjetit lëvizës.

Cdo vit në bashkëpunim me institucionet janë marrë masat për përballimin e situatave emergjente verore dhe atyre dimërore. Qendrat Shëndetësore furnizohen me medikamentet bazë të miratuara nga MSHC.

Nga NJVKSH Librazhd cdo ditë kryhet monitorimi i UJIT të pijshëm në 11 pika në Librazhd dhe në 5 pika në Prrenjas sipas aktmarrveshjes të lidhur me Ujësjellësit përkatës.

Për çdo rast të njoftimeve për sëmundjet infektive është kryer hetimi epidemiologjik në kontakt me pacientin dhe familjarët e tij, në zbatim të protokolleve përkatëse.

Ndërveprimi dhe bashkëpunimi me institucionet është korrekt.

Zyra Vendore e Punësimit

Zyra Vendore e Punesimit Librazhd eshte ne varesi te DRAKPA Elbasan (Drejtoria Rajonale e Agjencise Kombetare të Punësimit dhe Aftësive) dhe të AKPA (Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive Tirane). Është përgjegjëse për zbatimin e politikave të punësimit në territorin ku ajo vepron.

Qëllimi i zyrës së punës Librazhd është që të ketë një treg pune konkurues, eficient dhe fleksibël duke ndihmuar personat e papunë në gjetjen e punës.

Zyra Vendore e Punësimit Librazhd ka një strukturë organizative të përbërë nga përgjegjësi i zyrës dhe 3 specialistët, 2 specialistë me punëkërkuesit dhe 1 specialist më punëdhënësit.

Në zyrën e punës ofrohen shërbime për punëkërkuesit dhe punëdhënësit. Këtu përfshihen projektet e nxitjes së punësimit, projektet e vetëpunësimit, praktikat profesionale sipas VKM nr.17, puna në komunitet. Shërbim tjetër është pagesa e papunësisë për personat e dalë nga puna, ndihma ekonomike dhe shtresat vulnerable.

Dega e Thesarit Librazhd

Baza ligjore nr.9936,dt.26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligji 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, Udhezimi 9, dt.18.09.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”.

Në Degën e Thesarit Librazhd kalojnë veprime:

- Bashkia Librazhd
- Bashkia Prrenjas
- Spitali Librazhd
- Dshp Librazhd
- Dega Thesarit
- Zyra Arsimore Lb
- Zyra Arsimore Prrenjas
- Kalimet e veprimeve kanë vijuar normalisht në SIFQ për të gjitha keto institucione.
-

Tre institucione kalojmë veprimet nëpër Eëb-Portalit:

- Bashkia Librazhd
- Bashkia Prrenjas
- Zyra Arsimore Lb

Janë bërë rregullisht kalimet e sig.shoq dhe shëndetsore, pagave, tatimit mbi pagën, paaftesia, ndihma ekonomike, shpenzimet operative, investimet.Nuk ka pasur probleme në realizimin e objektivave funksionale për periudhën Janar-Dhjetor 2024.

Drejtoria Arsimore Librazhd

Organizimi i ZVAP-së Librazhd është mbështetur në Urdhërit Nr.234, date 19.04.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së zyrave vendore të arsimit parauniversitar”, të MAS-it.

E gjithë veprimtaria vjetore e ZVAP-së Librazhd është fokusuar në ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor cilësor në të gjitha IAP-të në bashkinë Librazhd, në përputhje me politikat, strategjitë rajonale dhe kurrikulën e arsimit parauniversitar, me qëllim zhvillimin

3.NËNPREFEKTURA PEQIN

Veprimtaria e Institucionit të Nënprefektit Peqin gjatë vitit 2024 është përqëndruar kryesisht në takime dhe bashkpunime me Drejtuesit e Institucioneve në Nënprefekturën Peqin si psh: Kryetarin e Bashkisë Peqin, Kryetarët e Njësive Vendore të Pajovës, Shezës, Gjocaj, Karinë dhe Përparim. Gjithashtu edhe me Drejtues Institucioneve kemi pasur marrëdhënie të shkëlqyera bashkpunimi si me Drejtorin e Policisë Peqin, Drejtorinë e

Shëndetit Publik dhe atij Spitalor Peqin, me Drejtorin e Oshe Peqin, Zyra Arsimore Peqin, Drejtorin e Postës Peqin gjithashtu edhe me Emergjencat Civile.

Gjatë periudhës së lartpërmendur, Institucioni i Nënprefektit Peqin ka zhvilluar një sërë takimesh dhe bashkëbisedime me qytetarët dhe institucione të ndryshme sipas problematikave të tyre duke i dhënë zgjidhje nga ana jonë si institucion.

Gjithashtu kemi zhvilluar dhe hartuar plane masash në bashkpunim me Emergjencat Civile, MZSHSH, ASHP, Drejtoria e Shërbimeve Pyjore Buqësore Veterinare dhe Mjedisit për përballimin e situatave emergjente të këtij viti, mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri dhe sigurimin teknik për mobilizimin e forcave për izolimin e zjarreve, organizimin e sistemit të vrojtimit dhe sinjalizimit, organizimin e punëve për shuarjen e zjarreve në pyje.

Kemi bashkpunuar me Bashkinë, Zyrën e Punës, Agjensinë e Buqësisë, Komisariatin e Policisë, Drejtorinë e Shërbimit Spitalor, Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, Zyrës Vendore Arsimore Parauniversitare, Degës së Thesarit, ASHK, Posta Peqin rreth raportimit të veprimtarisë së tyre mujore, dhe me Drejtorin e Përgjithme të Gjendjes Civile në lidhje me transferimin e dokumentacionit nga zyrat e gjendjes civile. Gjithashtu edhe me Drejtorinë e Përgjithshme e Arkivave mbi asistencën metodologjike në sekretari-arkivin e Rrethit Peqin.

Nënprefekti i Rrethit ka marrë pjesë dhe ka bashkpunuar në aktivitetet të organizuar nga Bashkia Peqin dhe Prefektura e Qarkut Elbasan.

Ka bashkpunuar me Bashkinë Peqin dhe Drejtorin Vendore të Policisë Elbasan për ngritjen e task-forcës lokale të sezonit turistik veror 2024 gjithashtu dhe për mbarëvajtjen e një procesi të sigurt të ambjeteve të brendshme dhe të jashtme përreth institucioneve arsimore.

Gjatë vitit 2024 puna e zyrës së gjendjes civile pranë Nënprefekturës Peqin është mbështetur në disa pika kryesore. Zbatimi i urdhërit nr.55 datë:12.05.2022 "Për miratimin e komisionit për koordibimin dhe monitorimin e shërbimit të gjendjes civile në sportelet online dhe fizike", dhe urdhërit nr.10181 prot datë 28.09.2023 "Lidhur me kalimin e ofrimit të lëshimit të certifikave online", urdhërin 7358/8 datë:01.07.2024" Për transferimin e dokumentacionit që admistrohen nga zyrat e gjendjes civile në bashki/ njësi administrative" dhe urdhërit 12854 datë.03.12.2024 "Për rikthimin e dokumentacionit të dorzuar nga zyrat e gjendjes civile në bashki/ njësi administrative."

Kryesisht puna e zyrës Gjendjes Civile është bërë si vijon: sistemimi dhe mirëmbajtja e arkivës si rregjistrat themeltar e akteve të ndryshme. Lëshimin e certifikave të ndryshme online si: Akte lindje, Akte vdekje, Akte martesë dhe certifikata të trungut familjar sipas viteve: 1930-1945, 1945-1950, 1950-1974 si dhe certifikata negative për aktet që mungojnë.

Një shërbim tjetër që ka kryer kjo zyrë është edhe legalizimi i dokumentacionit të qytetarëve për jasht shtetit. Ky numër legalizimesh gjatë vitit 2024 ka arritur një shifër prej 225.

Gjithashtu është ndjekur edhe Protokoli i Zyrës për shkresat e ardhura e të dërguara sipas kërkesës të institucioneve të ndryshme, duke zbatuar afatin ligjor të marrjes dhe dërgimit të shkresave.

Gjatë vitit 2024 puna e zyrës është mbështetur në komunikimin me të gjitha Zyrat e Gjendjes Civile të Njësive Vendore duke ndjekur problemat dhe bashkëpunimin me këto zyra.

PREFEKTI

Ali MYSLIU

